



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2023

“PËR

**ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË MJEKËSISË LIGJORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave nëpër organizimin dhe funksionimin shërbimit të mjekësisë ligjore në Republikën e Shqipërisë, kushtet që duhet të përmbushin shtetasit për të ushtruar detyrën e ekspertit ligjor, statusin, vlerësimin etik dhe profesional të tyre, procedimin disiplinor, përfundimin e marrëdhënies në Institutin e Mjekësisë Ligjore, si dhe marrëdhëniet me organet proceduese, institucionet shtetërore dhe me subjektet e tjera publike dhe private.

Neni 2

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e rregullave për mirëfunksionimin e shërbimit të mjekësisë ligjore në Republikën e Shqipërisë, si dhe unifikimin e procedurave për kryerjen e ekspertimeve në fushën e mjekësisë ligjore, në kuadër të mbështetjes së organeve të drejtësisë, institucioneve

shtetërore dhe subjektet e tjera publike dhe private për zgjidhjen e çështjeve hetimore e gjyqësore.

Neni 3 Përkufizime

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Akti i ekspertimit” është dokumenti që hartohet nga eksperti i ngarkuar për kryerjen e tij në përfundim të kryerjes së ekspertimit;

b) “Autopsia mjekoligjore” është procedura e ekzaminimit mjeko-ligjor për ekzaminimin e jashtëm dhe të brendshëm të kufomës, si dhe të mbetjeve mortore për përcaktimin e shkakut, mekanizmit, mënyrës dhe rrethanave të tjera që kanë të bëjnë me faktin e vdekjes;

c) “Ekspert ligjor” është personi fizik me njohuri të posaçme në fushën e mjekësisë ligjore, psikiatrisë ligjore, antropologjisë ligjore, anatomisë patologjiko-ligjore, toksikologjisë ligjore, biologjisë ligjore, i punësuar pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore;

ç) “Ekspertim ligjor” është procedura për ekzaminimin e kufomës, mbetjeve mortore, personave të gjallë, mostrave biologjike, dokumenteve të çështjes dhe ekzaminimeve të tjera mjeko-ligjore, sipas rregullave dhe përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;

d) “Ekzaminimi anatomopatologjiko-ligjor” është procedura për ekzaminimin mikroskopik të mostrave biologjike, pjesëza të gjithë indeve të trupit të kufomës, me qëllim përcaktimin e shkakut të vdekjes;

dh) “Ekspertimi antropologo-ligjor” është procedura për ekzaminimin e mbetjeve mortore me qëllim përcaktimin e identitetit të personit të vdekur, përcaktimi i shkakut të vdekjes si dhe përcaktimi i kohës së vdekjes;

e) “Ekspertimi biologjiko-ligjor” është procedura për ekzaminimin biologjik të mostrave biologjike, të marra nga personat e gjallë, kufomatose të marra gjatë këqyrjes së vendeve e sendeve për të bërë përcaktimet identifikuese individuale dhe krahasuese. Mostrat biologjike për efekt të ekspertimit biologjik janë: inde të buta, gjak, urinë, qime trupore, sekrecione biologjike apo eshtra;

ë) “Ekspertimi mjeko-ligjor” është procedura për ekzaminimin e kufomës, personave të gjallë dhe mostrave biologjike, si dhe në shqyrtimin e dokumenteve të çështjes, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

f) “Ekspertimi psikiatriko-ligjor” është procedura për ekzaminimin e personave të gjallë ose në shqyrtimin e dokumenteve të çështjes, për të bërë përcaktimet mbi gjendjen psikike të personit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shëndetin mendor;

g) “Ekspertimi toksikologo-ligjor” është procedura për ekzaminimin toksikologjik të mostrave biologjike, me qëllim përcaktimin e nivelit të alkoolit, lëndëve narkotike e psikotrope dhe lëndëve helmuese. Mostrat biologjike për efekt të ekspertimit toksikologjiko-ligjor janë: gjak, urinë, lëng vitroz, inde apo lëng gastrik të marra tek personat e vdekur gjatë autopsisë mjeko-ligjore ose tek personat e gjallë;

gj) “Konsulentët e jashtëm” janë mjekë specialistë të cilët thirren nga Instituti i Mjekësisë Ligjore për raste të posaçme, me qëllim këshillimin e ekspertëve në lidhje me rastet objekt ekspertimi, sipas fushave të tyre të specializimit;

h) “Mjeku ligjor i jashtëm” është mjek i cili mund të kontraktohet nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, jashtë organikës së Institutit, dhe kryen detyrat e ekspertit ligjor;

i) “Ministri” është ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë;

j) “Ministria” është ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë;

k) “Raporti i ekzaminimit biologjiko-ligjor” është dokumenti që hartohet nga eksperti biologjiko-ligjor sipas kërkesës së ekspertit mjeko-ligjor për ekzaminimin biologjik të mostrave biologjike;

l) “Raporti i ekzaminimit toksikologjiko-ligjor” është dokumenti që hartohet nga eksperti toksikolog ligjor sipas kërkesës së ekspertit mjeko-ligjor për ekzaminimin toksikologjik të mostrave biologjike;

ll) “Raporti i ekzaminimit anatomopatologjik ligjor” është dokumenti që hartohet nga eksperti anatomopatologjik ligjor sipas kërkesës së ekspertit mjeko-ligjor për ekzaminimin anatomopatologjiko-ligjor të personave të vdekur;

m) “Skeda e vdekjes” është dokument i cili përmban gjeneralitetet, kohën, vendin dhe shkakun e vdekjes, e cila plotësohet nga eksperti mjeko-ligjor në përfundim të autopsisë mjeko-ligjore;

n) “Teknikë të lartë” janë specialistë ndihmës në laboratore të ekspertëve mjeko-ligjor, toksikologo-ligjor, biologo-ligjor dhe anatomopatologjik ligjor në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe rregullores së Institutit të Mjekësisë Ligjore.

nj) “Prozektor” është ndihmës i mjekut ligjor, i cili merr pjesë në operacione teknike në hapjen e kufomës sipas kërkesave të procedurave të kërkuara nga mjeku ligjor.

2. Për qëllime të këtij ligji termi “ekspertim ligjor” përfshin të gjitha llojet e ekspertimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, përveçëse kur ligji në mënyrë të shprehur parashikon ndryshe.

Neni 4

Parimet bazë të shërbimit të mjekësisë ligjore

Shërbimi i mjekësisë ligjore kryhet në përputhje me parimet e mëposhtme:

- a) ligjshmërisë;
- b) paaanësisë dhe pavarësisë;
- c) profesionalizmit;
- ç) barazisë dhe mosdiskriminimit;
- d) respektimit të standardeve të larta etike dhe integritetit;
- dh) garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Neni 5

Ruajtja e konfidencialitetit

1. Informacionet e përfituara gjatë kryerjes së ekspertimeve ligjore janë konfidenciale dhe nuk bëhen publike.

2. Pas përfundimit të afatit të sekretit hetimor informacioni mund të jepet vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit.

3. Të gjitha të dhënat e mbledhura nga Instituti i Mjekësisë Ligjore ose eksperti ligjor ruhen dhe përpunohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 6

Pavarësia e ekspertit ligjor

1. Eksperti ligjor ushtron detyrat e tij, në përputhje me ligjin, praktikat ndërkombëtare më të mira të fushës si dhe protokollet mjekësore përkatëse.

2. Eksperti ligjor ushtron detyrat në mënyrë të pavarur, të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykime si dhe nuk duhet të krijojë kontakte të papërshtatshme me palët ose çdo person tjetër që ka një interes mbi çështjen.

KREU II

SHËRBIMI I MJEKËSISË LIGJORE

Neni 7

Organizimi i shërbimit të mjekësisë ligjore

1. Shërbimi i mjekësisë ligjore varet nga ministri dhe organizohet në nivel qendror dhe vendor, si vijon:

a) Instituti i Mjekësisë Ligjore, me seli në Tiranë, i cili përbën nivelin qendror të organizimit;
b) ekspertët ligjorë pranë spitaleve publike, të cilat përbëjnë nivelin vendor të organizimit dhe varen administrativisht nga Instituti i Mjekësisë Ligjore.

2. Rregulla të hollësishme lidhur me metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe ekspertëve ligjorë pranë spitaleve publike përcaktohen në rregulloren e Institutit të Mjekësisë Ligjore, e cila miratohet me urdhër të ministrit, me propozim të drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Neni 8

Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore

1. Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore përgjigjet për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e shërbimit të mjekësisë ligjore.

2. Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore emërohet dhe shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

3. Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të ketë përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për mjekësi, si dhe specializimin në mjekësi ligjore ose të ketë përfunduar studimet universitare në këto fusha jashtë vendit, të njohur dhe njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

c) të ketë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet përvojë në profesion, nga të cilat të paktën 5 (pesë) vite në fushën e mjekësisë ligjore;

ç) të mos jetë shkarkuar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

d) të plotësojë kriteret për të mos iu nënshtruar ndalimeve për t'u emëruar në një funksion publik sipas legjislacionit në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike;

dh) të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit në kuptimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;

e) të mos jetë dënuar me vendim penal të formës së prerë për vepra penale të kryera me dashje.

4. Funksioni i drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër shtetëror, me anëtarësimin në parti të politike dhe pjesëmarrjen në veprimtaritë e tyre, si dhe me çdo veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies.

Neni 9

Përgjegjësitë e drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore

1. Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore ka këto përgjegjësi:

a) drejton, bashkërendon dhe kontrollon veprimtarinë e Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe të ekspertëve ligjorë pranë spitaleve publike;

b) nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim mbi unifikimin dhe zbatimin e risive në kryerjen e ekspertimeve ligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji, pas marrjes së propozimit të Këshillit Shkencor dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;

c) emëron, liron dhe shkarkon ekspertët ligjorë, punonjësit administrativ dhe teknik të Institutit të Mjekësisë Ligjore, me përjashtim të ekspertëve të cilët shkarkohen nga Komisioni i Disiplinës;

ç) kontrollon dokumentimin e ekspertimeve ligjore;

d) organizon dhe kujdeset për trajnimin e ekspertëve ligjorë;

dh) ndihmon në hartimin e planeve të punës shkencore, në organizimin e seminareve dhe simpoziumeve, në bashkëpunim me njësitë përkatëse;

e) bashkëpunon me institucionet e arsimit të lartë në mbarëvajtjen e procesit pedagogjik dhe pasuniversitar, si dhe drejton kualifikimet afatshkurtra;

ë) përfaqëson Institutin e Mjekësisë Ligjore në marrëdhënie me të tretët;

f) i propozon projekt-buxhetin ministrit të Drejtësisë, si dhe kontrollon zbatimin vjetor të buxhetit të miratuar;

g) mban dhe zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione shtetërore apo private, vendase ose të huaja, për realizimin e veprimtarisë së shërbimit të mjekësisë ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi;

gj) promovon Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe veprimtarinë që kryhet prej tij, me qëllim përmirësimin e shërbimit të mjekësisë ligjore dhe rritjen e besimit të publikut ndaj këtij shërbimi;

h) administron morgjet e Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe morgjet në institucionet spitalore publike, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

i) ushtron përgjegjësi të tjera të përcaktuara me ligj ose me akte nënligjore.

2. Për përmbushjen e detyrave Institutit i Mjekësisë Ligjore është përgjegjës për:

a) mbajtjen e regjistrave të të gjitha rezultateve të ekspertimeve ligjore;

b) kualifikimin e vazhdueshëm të ekspertëve ligjorë, si dhe teknikëve të lartë e nëpunësve, veprimtaria e të cilëve lidhet me fushën e veprimtarisë së Institutit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe atë të kërkimit shkencor;

c) adresimin e problematikave për zhvillimin e ekspertimeve ligjore, si dhe marrjen e masave për përshtatjen e kushteve teknike dhe procedurave me standardet ndërkombëtare;

ç) çdo veprimtari tjetër të nevojshme për përmbushjen e funksionit të tij.

3. Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore u njofton dhe rekomandon institucioneve shëndetësore njohuritë dhe metodat e zbatueshme mjekësore tekniko-shkencore, në shërbim të praktikës së organeve të drejtësisë për zgjidhjen e çështjeve hetimore e gjyqësore, me karakter mjekësor dhe biologjik, me qëllim përdorimin e tyre nga institucionet shëndetësore në dobi të forcimit të disiplinës tekniko-shkencore, përmirësimit të cilësisë së punës diagnostike-mjekësore, studimin e shkaqeve të traumave, helmimeve apo të vdekjeve të papritura, si dhe parandalimin e rasteve të pakujdesive apo gabimeve mjekësore.

4. Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore raporton çdo vit pranë ministrit lidhur me veprimtarinë e kryer, duke përfshirë numrin dhe llojin e ekspertimeve mjeko-ligjore të realizuara përgjatë vitit kalendarik, mbledhjen e të ardhurave, realizimin e buxhetit si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm. Modeli i raportit vjetor miratohet me urdhër të ministrit të Drejtësisë me propozim të drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

5. Në ushtrim të kompetencave të tij drejtori nxjerr urdhra dhe udhëzime.

Neni 10

Zëvendësdrejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore

1. Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore mbështetet nga zëvendësdrejtori. Zëvendësdrejtori përfaqëson Institutin e Mjekësisë Ligjore, në mungesë dhe me autorizim të Drejtorit ose kur vendi i tij është përkohësisht i lirë.

2. Zëvendësdrejtori drejton punën sipas fushave, organizimit dhe ndarjes së përgjithshme të punës të bërë nga drejtori dhe detyrat e caktuara prej tij. Zëvendësdrejtori përgjigjet para drejtorit për mbarëvajtjen e detyrave të ngarkuara prej tij.

3. Zëvendësdrejtori emërohet nga me urdhër të ministrit, me propozim të drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore. Zëvendësdrejtori duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për mjekësi, farmaci, kimi ose biologji, me diplomë “Master i shkencave” ose “Master profesional”, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike apo të barasvlershme me to, ose të ketë përfunduar studimet universitare në këto fusha jashtë vendit, të njohur dhe njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

c) të ketë jo më pak se 5 (pesë) vjet përvojë në profesion;

ç) të mos jetë shkarkuar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

d) të plotësojë kriteret për të mos iu nënshtruar ndalimeve për t'u emëruar në një funksion publik sipas legjislacionit në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

dh) të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit në kuptimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;

e) të mos jetë dënuar me vendim penal të formës së prerë për vepra penale të kryera me dashje.

4. Funksioni i zëvendës drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër shtetëror, me anëtarësimin në parti të politike dhe pjesëmarrjen në veprimtari të tyre, si dhe me çdo veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies.

Neni 11

Këshilli Shkencor

1. Këshilli Shkencor është organ këshillimor i Institutit të Mjekësisë Ligjore që ka si funksion unifikimin dhe zbatimin e risive në kryerjen e ekspertimeve ligjore të parashikuara në këtë ligj.

2. Këshilli përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët:

a) 3 (tre) prej të cilëve janë ekspertë ligjorë të Institutit të Mjekësisë Ligjore, me jo më pak se 5 (pesë) vite eksperiencë në mjekësinë ligjore, të zgjedhur me votim nga shumica e ekspertëve ligjorë të Institutit të Mjekësisë Ligjore; dhe

b) 2 (dy) punonjës të stafit pedagogjik të caktuar nga institucionet publike të arsimit të lartë në fushën e mjekësisë, të cilët kanë ushtruar profesionin e mjekut për jo më pak se 10 (dhjetë) vite.

3. Anëtarët e Këshillit emërohen për një afat 3 (tre) vjeçar, me të drejtë riemërimi.

4. Sekretari i Këshillit Shkencor zgjidhet me votim të hapur nga anëtarët e Këshillit dhe është përgjegjës përmbarëvajtjen e Këshillit nga ana organizative.

4. Rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Shkencor përcaktohen në rregulloren e Institutit të Mjekësisë Ligjore.

5. Masa e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Shkencor caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas rregullave të përcaktuara për shpërblimin e anëtarëve të organeve kolegjiale.

Neni 12

Funksionet e Këshillit Shkencor

1. Këshilli Shkencor kryen veprimtari kërkimore-shkencore bazë ose të zbatuar, studime, projekte për zhvillim, si dhe veprimtari të tjera krijuese e hulumtuese në fushën e mjekësisë ligjore, me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e rritjes së cilësisë së ekspertimeve që ofron Instituti i Mjekësisë Ligjore.

2. Këshilli Shkencor i Institutit të Mjekësisë Ligjore, shqyrton dhe miraton:

a) projektet e kërkimit shkencor dhe zhvillimit të Institutit;

b) studimet e kryera në përfundimin e zbatimit të projekteve;

- c) udhëzimin praktik për kryerjen e ekspertimeve.
3. Këshilli Shkencor i propozon drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore:
- a) marrëveshjet e bashkëpunimit shkencor me institucionet homologe të vendit dhe të huaja;
 - b) programet e ngritjes tekniko-profesionale të personelit teknik të lartë të Institutit;
 - c) programet e organizimit të konferencave dhe simpoziumeve shkencore në rang kombëtar dhe ndërkombëtar ku Instituti merr pjesë;
 - ç) programet e brendshme të specializimit dhe kualifikimit pas universitar që realizohen në ambientet e Institutit;
 - d) udhëzime të përgjithshme me shkrim mbi unifikimin dhe zbatimin e risive në kryerjen e ekspertimeve ligjore.
3. Këshilli Shkencor është përgjegjës për miratimin e artikujve shkencor në revistën e mjekësisë ligjore të Institutit.
4. Këshilli Shkencor mbështet çdo ekspert të Institutit të Mjekësisë ligjore për të ushtruar veprimtari kërkimore-shkencore me qëllim përfitimin e aftësive shtesë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional dhe të karrierës mjekësore dhe akademike.

Neni 13

Ushtrimi i veprimtarisë në nivel vendor

1. Instituti i Mjekësisë Ligjore ushtron veprimtarinë e tij në nivel vendor nëpërmjet ekspertëve ligjorë pranë spitaleve publike, me qëllim ofrimin e shërbimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Ekspertët që ushtrojnë veprimtarinë pranë spitaleve publike janë pjesë e strukturës së Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe përgjigjen para drejtorit të Institutit për detyrat e kryera.

Neni 14

Organika

1. Numri i përgjithshëm i ekspertëve ligjorë të shërbimit të mjekësisë ligjore si dhe numri i ekspertëve ligjorë sipas fushave të specializimit, caktohet me urdhër të ministrit, pasi më parë është marrë mendimi me shkrim i Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe ministrit përgjegjës për financat.
2. Struktura dhe organika e Institutit të Mjekësisë Ligjore miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislationit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore duke mbajtur në konsideratë, por pa u kufizuar, organizimin e rretheve gjyqësore në territorin e Republikës së Shqipërisë lidhur me spitalet publike në të cilat ushtrojnë veprimtarinë ekspertët ligjorë në nivel vendor.

Neni 15

Konsulentët e jashtëm, mjekët ligjorë të jashtëm dhe shkruarit e akteve të ekspertimit

1. Instituti thërret si konsulentë të jashtëm mjekë specialistë, në fusha të ndryshme të mjekësisë, për raste të posaçme.

2. Në varësi të nevojave Instituti kontraktton mjekë ligjorë, në nivel vendor, jashtë strukturës së Institutit të Mjekësisë Ligjore, të të gjitha fushave të cilët kanë mbaruar ciklin e studimeve për mjekësi dhe janë trajnuar jo më pak se 3 (tre) muaj pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore, për qëllime të plotësimit të nevojave dhe përmbushjes së detyrave të tij funksionale.

3. Instituti kontraktton personel mbështetës për ekspertët, sipas parashikimeve të Kodit të Punës, për shkrimin e akteve të ekspertimit, punonjës të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe kanë njohuri të certifikuara në përdorimin e pajisjeve elektronike.

4. Në zbatim të këtij neni, Instituti i Mjekësisë Ligjore lidh kontrata punësimi të përkohshme, në përputhje me parashikimet e Kodit të Punës. Këto kontrata mund të zgjaten në varësi të nevojave që ka institucioni.

Neni 16

Lista e ekspertëve

1. Instituti i Mjekësisë Ligjore vendos në dispozicion të organeve gjyqësore dhe të prokurorisë listën e ekspertëve ligjorë.

2. Lista e ekspertëve përmban emrin, mbiemrin, fushën e specializimit të ekspertit, vendin ku ushtron veprimtarinë në nivel qendror apo lokal si dhe të dhënat e kontaktit. Në këtë listë shënohen edhe mjekët e jashtëm përgjatë kohës që kontraktohen nga Instituti i Mjekësisë Ligjore.

3. Lista publikohet edhe në faqen zyrtare të Institutit të Mjekësisë Ligjore për njohje nga subjektet e tjera dhe palët private që mund të kërkojnë ekspertim ligjor.

4. Veprimtaria e mjekësisë ligjore nuk mund të ushtrohet nga asnjë person që nuk është pjesë e kësaj liste.

5. Ekspertët ligjorë regjistrohen edhe në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve, i cili administrohet nga ministria, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

Neni 17

Bashkëpunimi me institucionet e tjera

1. Shërbimi i mjekësisë ligjore në përmbushje të misionit dhe përgjegjësi, bashkërendon veprimtarinë me:

- a) institucionet shëndetësore,
- b) institucionet homologe ndërkombëtare në fushën e ekspertimeve ligjore;
- c) institucione të tjera të administratës publike.

2. Bashkëpunimi me gjykatën, prokurorinë, organet ligjzbatuese, dhe personat e tretë realizohet në zbatim të legjislacionit në fuqi.

3. Instituti i Mjekësisë Ligjore lidh marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 18

Burimet financiare

1. Për realizimin e detyrave, shërbimi i mjekësisë ligjore ka buxhetin e vet, si pjesë e veçantë brenda buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë. Shërbimi i mjekësisë ligjore financohet nga buxheti i

shtetit, nga të ardhurat që krijon nga tarifat për kryerjen e veprimtarisë së tij, si dhe çdo burim tjetër i ligjshëm.

2. Instituti i Mjekësisë Ligjore ka të drejtë të përdorë të ardhura të tjera të krijuara nga shërbimi i mjekësisë ligjore, për të mbuluar shpenzimet e Institutit dhe investimet në të me qëllim pajisjen me infrastrukturën dhe logjistikën e përshtatshme, si dhe zbatimin e metodave dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Neni 19

Marrëdhëniet e punës në Institutin e Mjekësisë Ligjore

1. Marrëdhëniet e punës të ekspertëve ligjorë rregullohen sipas këtij ligji dhe Kodit të Punës.
2. Marrëdhëniet e punës së personelit ndihmës, shkruesit e akteve dhe personeli administrativ i Institutit të Mjekësisë Ligjore rregullohen sipas Kodit të Punës.
3. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve civilë të Institutit të Mjekësisë Ligjore rregullohen sipas legjisllacionit në fuqi për nëpunësin civil.

KREU III

EMËRIMI I EKSPERTIT LIGJOR

Neni 20

Licencimi i ekspertit ligjor

1. Ekspertët ligjorë licencohen në fushën përkatëse të specializimit, nga Komisioni i Licencimit.
2. Asnjë person nuk mund të emërohet si ekspert ligjor pa u pajisur më parë me licencën për ushtrimin e veprimtarisë në shërbimin e mjekësisë ligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji.
3. Kushtet dhe procedura e licencimit të ekspertëve ligjorë si dhe përbërja, mënyra e organizimit dhe funksionimi i Komisionit të Licencimit pranë ministrisë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 21

Kushtet për emërimin e ekspertit ligjor

1. Shtetasi, që kërkon të emërohet si ekspert ligjor, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:
 - a) të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;
 - b) të jetë licencuar si ekspert ligjorë;
 - c) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor penal të formës së prerë;
 - ç) të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose funksionit publik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë;
 - d) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
2. Përveç kriterëve të parshikuar në pikën 1 të këtij neni, shtetasi, që kërkon të emërohet si ekspert ligjorë duhet të përmbushë edhe kushtet e mëposhtme:

a) shtetasi që kërkon të emërohet si ekspert mjeko-ligjor duhet të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në mjekësi apo të ketë diplomë ekuivalente me të, si dhe specializimin në mjekësi ligjore, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

b) shtetasi që kërkon të emërohet si ekspert toksikologo-ligjor duhet të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në degët Farmaci ose Kimi, apo të ketë diplomë të njehësuar me to, si dhe të ketë kualifikime ose trajnime në fushën e analizës toksikologjike sipas legjislacionit në fuqi;

c) shtetasi që kërkon të emërohet si ekspert biologo-ligjor duhet të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në degën Biologji ose të ketë diplomë të njehësuar me të sipas legjislacionit në fuqi;

ç) shtetasi që kërkon të emërohet si ekspert psikiatro-ligjor duhet të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në mjekësi ose të ketë diplomë të njehësuar me të, si dhe specializim në psikiatri sipas legjislacionit në fuqi;

d) shtetasi që kërkon të emërohet si ekspert antropologo-ligjor duhet të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në mjekësi ose të ketë diplomë të njehësuar me të, si dhe kualifikime ose trajnime në fushën e antropologjisë ligjore sipas legjislacionit në fuqi;

dh) shtetasi që kërkon të emërohet si ekspert anatomopatologo-ligjor duhet të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në mjekësi ose të ketë diplomë të njehësuar me të, si dhe specializim në fushën e anatomisë patologjike sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 22

Kushtet për emërimin teknikëve të lartë të laboratorëve dhe prozektorit

1. Shtetasi, që kërkon të emërohet si specialist teknik i lartë laboratorit, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;

b) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor penal të formës së prerë;

c) të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose funksionit publik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë;

ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

2. Përveç kriterëve të parshikuar në pikën 1 të këtij neni, shtetasi, që kërkon të emërohet si specialist teknik i lartë laboratorit duhet të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në shkencë mjekësore teknike apo të ketë diplomë të njehësuar me të, sipas legjislacionit në fuqi;

3. Përveç kriterëve të parshikuar në pikën 1 të këtij neni, shtetasi, që kërkon të emërohet si prozektor, duhet të ketë përfunduar arsimin e mesëm. Prozektorit që përmbush kushtet e përcaktuara në këtë nen, i nënshtrohet trajnimit pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore për një periudhë 3 (tre) mujore, përpara emërimit të tij. Rregullat e detajuara për trajnimin dhe vlerësimin e prozektorit përcaktohen në rregulloren e Institutit të Mjekësisë Ligjore.

4. Teknikët e lartë të laboratorit dhe prozektorët emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra nga Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Neni 23

Pranimi në shërbimin e mjekësisë ligjore

1. Pranimi në shërbimin e mjekësisë ligjore bëhet nëpërmjet konkursit të hapur, i cili organizohet nga Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore.

2. Procesi i përzgjedhjes përfshin provimin e pranimit, që planifikohet për zhvillim bazuar mbi kërkesat dhe nevojat publike për numrin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 14 të këtij ligji.

3. Të gjithë individët që përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 21 të këtij ligji, kanë të drejtë t'i nënshtrohen provimit të pranimit për ekspert ligjor.

4. Rregulla të hollësishme për organizimin, zhvillimin, përmbajtjen e provimit të pranimit, si dhe procedurën e vlerësimit dhe shpalljes së rezultateve përcaktohen me urdhër të ministrit, me propozim të Drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Neni 24

Periudha e provës

1. Kandidatët fitues i nënshtrohen një periudhe prove që zgjat 6 (gjashtë) muaj nga data e aktit të emërimit të drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

2. Gjatë periudhës së provës, eksperti ligjor kryen detyrat nën kujdesin e një eksperti të vjetër në detyrë dhe i nënshtrohet trajnimit të detyrueshëm.

3. Eksperti ligjor gjatë periudhës së provës gëzon të drejtat dhe detyrimet e ekspertit ligjor të shërbimit të mjekësisë ligjore, të përcaktuara në këtë ligj dhe në akte të tjera.

4. Në fund të periudhës së provës, drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore, vendos:

a) emërimin përfundimtar si ekspert ligjor; ose

b) largimin nga shërbimi i mjekësisë ligjore.

5. Vendimmarrja, sipas pikës 4 të këtij neni, bazohet në çdo rast në vlerësimin e rezultateve në punë nga eksperti ligjor mbikëqyrës dhe në rezultatin e testimit në përfundim të ciklit të trajnimit.

Neni 25

Programi i detyrueshëm i trajnimit për ekspertët

1. Programi i detyrueshëm i trajnimit për ekspertët ligjor në periudhë prove zhvillohet për një kohëzgjatje prej jo më pak se 200 orësh në 6 (gjashtë) muaj dhe ka si qëllim aftësimin e tyre me njohuritë e duhura profesionale për ushtrimin e detyrës së ekspertit ligjor të shërbimit të mjekësisë ligjore.

2. Programi i detyrueshëm i trajnimit realizohet nga Instituti i Mjekësisë Ligjore ose nga institucione të arsimit të lartë të akredituara sipas ligjit.

3. Organizimi dhe përmbajtja e programit të trajnimit, rregullat për pjesëmarrjen në trajnime, si dhe për testimin e njohurive të përfituara përcaktohen me urdhër të ministrit, me propozim të Drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Neni 26

Lirimi nga detyra i ekspertëve ligjorë

1. Ekspertët ligjorë lirohen nga detyra kur:

- a) japin dorëheqjen;
- b) mbushin moshën për daljen në pension;
- c) shkurtohet pozicioni përkatës i punës.

Neni 27

Shkarkimi nga detyra i ekspertëve ligjorë

1. Ekspertët ligjorë shkarkohen nga detyra kur:
- a) marrin masë disiplinore për shkelje të rëndë;
 - b) dënohen me vendim penal të formës së prerë për një veprë penale të kryer me dashje;
 - c) mungojnë në detyrë për një periudhë kohore më të gjatë se 3 (tre) muaj pa shkaqe të justifikuara në vit;
 - ç) u është hequr zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

KREU IV

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E EKSPERTIT LIGJOR

Neni 28

Të drejtat e ekspertit ligjor

Eksperti ligjor ka të drejtat e mëposhtme:

- a) të ofrojë shërbimin e mjekësisë ligjore në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi në mënyrë të pavarur;
- b) të shpërblehet korrektësisht për punën e kryer;
- c) të shohë aktet, dokumentet dhe gjithçka që përfshihet në fashikullin e prokurorit ose të gjykatës, me autorizimin e organit procedues,;
- ç) të kërkojë, kur e konsideron të nevojshme për veprimtarinë e tij, çdo informacion që është i nevojshëm për kryerjen e ekspertimit, nga institucione shtetërore, persona juridikë apo fizikë, në përputhje me ligjin;
- d) t'i sigurohet mbrojtja e integritetit fizik, moral dhe dinjitetit;
- dh) të anëtarësohet në sindikata apo shoqata profesionale;
- e) të përmirësojë aftësitë profesionale nëpërmjet programit të formimit vazhdues;
- ë) të përfitojë trajtim shëndetësor dhe sigurime shëndetësore në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- f) çdo të drejtë tjetër që i garantohet nga ky ligj dhe akte të tjera në fuqi.

Neni 28

Mbrojtja e veçantë e ekspertit

1. Kur ekspertit gjatë ushtrimit të detyrës së tij ose për shkak të saj i rrezikohet jeta, shëndeti, familja apo prona, i garantohet mbrojtje e veçantë.
2. Kushtet dhe mënyra e përfitimit të kësaj mbrojtjeje përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 29

Detyrat e ekspertit ligjor

Eksperti gjatë ushtrimit të veprimtarisë kryen detyrat e mëposhtme:

- a) kryen veprimtarinë e ekspertimit me ndershmëri, paañesi, profesionalizëm dhe në interes të përmbushjes së detyrave të caktuara nga organi procedues ose palët e treta;
- b) paraqitet në seancat gjyqësore, në përputhje me parashikimet ligjore;
- c) respekton dhe zbaton rregullat e etikës dhe standardet profesionale në ushtrimin e detyrës, duke garantuar ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te shërbimi i mjekësisë ligjore;
- ç) ruan sekretin profesional dhe konfidencialitetin e të dhënave për të cilat është vënë në dijeni nga faktet, rrethanat ose dokumentet e vëna në dispozicion për ekspertim, përveç kur dhënia e këtij informacioni është detyrim ligjor;
- d) zbaton në mënyrë korrekte dispozitat e këtij ligji, Kodit të Procedurës Penale dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, që lidhen me kryerjen e ekspertimeve, si dhe udhëzimet e përgjithshme me shkrim të drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore;
- dh) informon për çdo veprim procedural organin e procedurës ose palët e treta që kanë kërkuar kryerjen e ekspertimit, si dhe jep sqarimet e nevojshme për veprimet e kryera;
- e) merr çdo masë të arsyeshme për t'u përditësuar me ndryshimet legjislativë, praktikën gjyqësore dhe zhvillimet shkencore në fushën e tij të ekspertizës;
- ë) përmirëson në mënyrë të vazhdueshme kualifikimet profesionale në fushën e ekspertimit të tij si dhe merr pjesë në trajnime të organizuara për këtë qëllim nga institucionet qëndrore, institucionet e arsimit të lartë apo shoqatat; si dhe,
- f) çdo detyrë tjetër sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 30

Detyrimi për të kryer ekspertimin

Eksperti ligjor nuk mund të refuzojë kryerjen e një ekspertimi përveç rasteve kur gjendet në kushte papajtueshmërie ose konflikti i interesit, apo kur ka një pengesë ligjore për kryerjen e ekspertimit, sipas legjislacionit procedural në fuqi.

Neni 31

Kujdesi në ushtrimin e veprimtarisë

1. Eksperti, në kryerjen e veprimtarisë duhet të veprojë me kujdesin e duhur dhe në përputhje me ligjin dhe rregullat e ushtrimit të profesionit.
2. Eksperti mban përgjegjësi për rezultatet e ekspertimit.

Neni 32

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

1. Eksperti ligjor ndjek programin e formimit vazhdues, i cili ka për qëllim përditësimin e njohurive dhe zhvillimin e kompetencave të tyre.
2. Programi i formimit vazhdues përcakton objektivat, modulet e trajnimit, organizimin e trajnimeve dhe kohëzgjatjen e tyre, rregullat e frekuentimit, mënyrën e kontrollit të njohurive dhe aftësive, si dhe rregulla të tjera të hollësishme për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të ekspertëve ligjorë.
3. Programi i formimit vazhdues realizohet nga Instituti i Mjekësisë Ligjore ose nga institucione të arsimit të lartë të akredituara sipas ligjit.
4. Organizimi dhe përmbajtja e programit të trajnimit si dhe rregullat për pjesëmarrjen në trajnime përcaktohen me urdhër të ministrit, me propozimin e drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Neni 33

Papajtueshmëritë me funksionin e ekspertit

1. Eksperti ligjor nuk mund të ushtrojë njëkohësisht funksione apo veprimtari publike dhe të kryejë veprimtari që vijnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji ose janë të papajtueshme me ushtrimin e detyrës së ekspertit ligjor.
2. Eksperti ligjor nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër politike, shtetërore ose profesionale, që realizohet kundrejt pagesës, me përjashtim të mësimdhënies ose veprimtarisë shkencore.
3. Funksioni i ekspertit ligjor është i papajtueshëm me:
 - a) anëtarësinë në parti politike dhe pjesëmarrjen në veprimtari politike të organizuara nga një parti politike;
 - b) kryerjen e çdo veprimtarie politike, pavarësisht nëse veprimtaria kryhet në bashkëpunim ose jo me ndonjë parti politike.

Neni 34

Konflikti i interesit

1. Eksperti është i detyruar të mos pranojë ekspertimin e çështjes ose të heqë dorë nga ekspertimit, nëse ka filluar, nëse ai ka marrë dijeni ose duhet të kishte marrë dijeni për ekzistencën e një shkakut, që tregon një konflikt interesi, kur:
 - a) ka një interes në çështjen përkatëse ose në një çështje tjetër, që ka lidhje me atë në ekspertim;
 - b) me njërin nga palët në proces ekspertimi ose me përfaqësuesit është bashkëshortë, bashkëjetues, gjini e afërt ku përfshihen të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave ose krushqi e afërt ku përfshihen vjehërr,

vjehrrë, dhëndër, nuse, kumatë, thjeshtri, thjeshtira, njerku e njerka, ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme;

c) eksperti vetë ose bashkëorti/bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor a në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve në proces ekspertimi ose njërin prej përfaqësuesve;

ç) është kujdestar, punëdhënës i njëres prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër, që ka interesa për çështjen për të cilën kryhet ekspertimi;

d) në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.

2. Mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga eksperti, i cili ka dijeni ose duhet të kishte marrë dijeni për ekzistencën e konfliktit të interesit, konsiderohet shkelje disiplinore.

Neni 35

Heqja dorë nga ekspertimi

1. Eksperti, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka arsye për të mos marrë pjesë në ekspertimin e një çështjeje për shkak të konfliktit të interesit, i paraqet menjëherë kërkesën për heqje dorë nga ekspertimi organit procedues që e ka caktuar për kryerjen e ekspertimit.

2. Përmbajtja e kërkesës për heqje dorë nga ekspertimi dhe vendimi u njoftohet palëve në proces.

Neni 36

Praktika të ndaluara

1. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, eksperti nuk duhet të kryejë veprime që cenojnë vërtetësinë e rezultateve të ekspertimit apo subjektet që u nënshtrohen procedurave të ekspertimit.

2. Ndalohet veçanërisht kryerja e veprimtarive të mëposhtme:

a) përdorimi i dhunës apo forcës për kryerjen e ekspertimeve;

b) kërcënimi fizik apo presioni psikologjik ndaj subjekteve të ekspertimit;

c) përdorimi i fjalëve të pahijshme, që cenojnë reputacionin apo dinjitetin e subjekteve, që i nënshtrohen ekspertimit;

ç) angazhimi në ndonjë praktikë të ndaluar ose përdorimi i ndonjë metode të pandershme në kryerjen e ekspertimit në kundërshtim me metodat e punës;

d) angazhimi i personave të tjerë të paemëruar për ushtrimin e veprimtarisë së ekspertimit;

dh) çdo veprim tjetër me karakter mashtrues, i cili kompromenton procesin e ekspertimit dhe integritetin moral të ekspertit.

Neni 37

Konfidencialiteti

Eksperti, i cili merr informacione gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, ruan konfidencialitetin e këtyre të dhënave dhe nuk duhet t'ua japë këto informacione të tretëve, përveç:

a) organeve të rendit publik, prokurorisë ose gjykatës;

b) Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe ministrit, vetëm për efekt të ushtrimit të kompetencave.

Neni 38

Vula dhe dokumenti i identifikimit

1. Eksperti ligjor ka vulën e vet personale që përmban emrin e tij dhe vendoset në çdo dokument që ai krijon gjatë veprimtarisë së tij në shërbimin e mjekësisë ligjore.
2. Eksperti ka dokument identifikues, të cilin e paraqet në çdo rast të ushtrimit të detyrës. Dokumenti përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj.
3. Dokumenti i identifikimit përmban:
 - a) emrin, mbiemrin e ekspertit;
 - b) stemën e Republikës së Shqipërisë dhe logon e Institutit të Mjekësisë Ligjore;
 - c) vendin e ushtrimit të veprimtarisë si ekspert, në nivel qendror apo vendor.
4. Forma e vulës dhe dokumentit të identifikimit përcaktohet me urdhër të ministrit me propozim të drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Neni 39

Dorëzimi i dokumentacionit pas largimit nga detyra

1. Kur eksperti largohet nga detyra sipas rasteve të parashikuara në këtë ligj dhe ka në proces ekspertime të papërfunduara, dorëzon dokumentacion, rezultatet e veprimeve të kryera dhe të dhënat e tjera që disponon mbi objektin e ekspertimit në organin procedues.
2. Rregulla të hollësishme për procedurën dhe afatet e dorëzimit të përcaktohen me propozim të Drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe me miratim të ministrit.

KREU V

TRAJTIMI FINANCIAR I EKSPERTIT LIGJOR

Neni 40

Pagat e ekspertëve në Institutin e Mjekësisë Ligjore

1. Paga e ekspertëve duhet të jetë në përputhje me natyrën e përgjegjësisë së detyrës së ekspertit dhe e përshtatshme për të garantuar pavarësinë dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e jashtme në ushtrim të funksionit të tyre.
2. Paga e Drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore, Zëvendës Drejtorit dhe ekspertëve ligjorë funksional përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe nuk mund të jetë më e ulët se paga mujore e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë.
3. Mjeku ligjor i jashtëm dhe konsulenti i jashtëm paguhet në bazë të punës së kryer me pagë orare të ekspertit funksional.

4. Eksperti, në varësi të rezultateve në punë, mund të përfitojë një shpërblim, i cili përballohet nga të ardhurat që i mbeten Institutit të Mjekësisë Ligjore, në përputhje me nenin 14 të këtij ligji. Shpërblimi i posaçëm caktohet në çdo rast me urdhër të ministrit.

Neni 41 Përfitime të tjera

1. Eksperti gëzon të drejtën e pushimeve vjetore të paguar prej 4 (katër) javësh kalendarike. Si rregull. Eksperti, i ngarkuar me detyra të ngutshme në këtë periudhë, pushimin vjetor e kryen në një periudhë tjetër, duke përfituar 5 (pesë) ditë pushimi shtesë.

2. Pushimi vjetor jepet nga drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore.

3. Eksperti ka të drejtë që në raste të veçanta, për nevoja personale ose familjare, të kërkojë leje pa të drejtë page. Kohëzgjatja e lejes pa të drejtë page përcaktohet nga drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore. Kohëzgjatja maksimale e lejeve të papaguara brenda një viti kalendarik nuk mund të jetë më e gjatë se 30 (tridhjetë) ditë.

4. Eksperti mund të kërkojë leje të papaguar deri në 2 (dy) vjet për arsye shëndetësore ose për qëllime kualifikimi apo specializimi profesional. Leja e papaguar sipas kësaj pike merret e gjitha njëherësh ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së ekspertit.

5. Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore mund të japë lejen e papaguar sipas pikës 4, nëse leja nuk cenon interesat e funksionit dhe nuk vë në rrezik në tërësi përmbushjen e funksionit me eficiencë dhe në kohë të Institutit. Periudha e lejes së papaguar nuk merret në konsideratë për vjetërsinë në punë ose për efekt të përfitimeve të tjera.

6. Ministri, me propozim të Drejtorit të Institutit të Mjekësisë ligjore, miraton rregulla më të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar, sipas këtij neni.

Neni 42 Koha e punës

1. Koha normale e punës për ekspertët mjeko-ligjorë, toksikologjiko-ligjorë, biologjiko-ligjorë, psikatriko-ligjorë, antropologo-ligjorë, anatomopatologo-ligjorë dhe për teknikët e lartë të laboratorit është 6 (gjashtë) orë në ditë.

2. Për nevoja pune, me kërkesë të organit procedues, eksperti është i detyruar të punojë edhe jashtë orarit të punës në ditët e pushimit ose në ditët e festave zyrtare, brenda kufijve të përcaktuar në Kodin e Punës. Në këto raste zbatohen rregullat për kompensimin e orëve shtesë, sipas Kodit të Punës.

KREU VI

RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR KRYERJEN E EKSPERTIMIT

Neni 43 Kryerja e ekspertimit

1. Eksperti ligjor kryen ekspertim me vendim të prokurorit, të policisë gjyqësore, gjykatës, Avokatit të Popullit si dhe me kërkesë të palëve private në çështjet hetimore apo gjyqësore.
2. Eksperti kryen ekspertim me kërkesë të organeve të tjera ligjzbatuese, bazuar në marrëveshjet e përbashkëta të Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe institucioneve të interesuara.
3. Eksperti kryen ekspertim edhe me kërkesë të palëve private jashtë një procesi hetimor apo gjyqësor.
4. Ekspertimet ligjore kryhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjorë të nxjerra në zbatim të tij, si dhe udhëzuesit praktikë mbi metodat e punës.
5. Çdo ekspert kryen llojet e ekspertimeve që janë në kompetencë të tij dhe ka të drejtë të refuzojë t'u përgjigjet pyetjeve që kapërcejnë kufijtë e njohurive të tij.
6. Eksperti kryen ekspertimin në përputhje me rregullimet ligjore, udhëzuesit praktik të mjekësisë ligjore dhe dorëzon ekspertimin në afatet e caktuara.
7. Kur eksperti konstaton se materialet e prokurorisë ose të gjykatës janë të pamjaftueshme, ka të drejtë të njoftojë për pamundësinë e dhënies së mendimit dhe të kërkojë materiale shtesë.
8. Kur ekspertët e caktuar janë më shumë se një dhe kanë ndryshime mendimesh midis tyre, secili ka të drejtë të parashtrijë mendimin e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
9. Eksperti ka të drejtë të kërkojë nga organet e drejtësisë ose institucionet shëndetësore ndihmën e specialistëve të ndryshëm, si dhe shtrimin në qendrën spitalore të burgut të personave që do të ekzaminohet, kur kjo është e nevojshme.

Neni 44

Akti i ekspertimit

1. Në përfundim të ekspertimit të kryer, eksperti paraqet mendimin e tij me shkrim, nëpërmjet aktit të ekspertimit.
2. Akti i ekspertimit hartohet në gjuhën shqipe dhe formulohet në një gjuhë të kuptueshme edhe për personat të cilët nuk kanë njohuri në fushën mjekësore.
3. Në pjesën hyrëse së aktit të ekspertimit, përcaktohen eksperti që kryen ekspertimin, gjeneralitetet e subjektit të ekspertimit, rrethanat e çështjes dhe pyetjet që kërkohet t'u jepen përgjigje.
4. Në pjesën përshkruese-arsyetuese të aktit të ekspertimit bëhet përshkrimi i hollësishëm i hapave të ekspertimit dhe të gjithë rezultatet e dala gjatë këtij procesi, të argumentuara shkencërisht.
5. Në pjesën e konkluzioneve, përcaktohen përfundimet e arritura gjatë ekspertimit në përgjigje të pyetjeve të kërkuara, në mënyrë të saktë dhe pa mëdyshje.
6. Akti i ekspertimit përpilohet në dy kopje origjinale, njëra prej të cilave dërgohet pranë organit apo subjektit kërkues, brenda afateve të përcaktuara, me shkresë përcjellëse, ndërsa kopja tjetër ruhet në arkivin e Institutit të Mjekësisë Ligjore.
7. Akti i ekspertimit ligjor është i vlefshëm kur është i nënshkruar dhe vulosur nga eksperti i ngarkuar për të kryer këtë ekspertim.
8. Rregulla të hollësishme për përpilimin e aktit të ekspertimit ligjor dhe mënyrën e administrimit të tij përcaktohen në rregulloren e Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Neni 45

Afatet e dorëzimit të aktit të ekspertimit

Eksperti dorëzon aktin e ekspertimit, brenda afateve të përcaktuara në vendimin apo kërkesën për ekspertim, kur është i përcaktuar, si dhe në përputhje me afatet e parashikuara në rregulloren e Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe udhëzuesit praktikë të punës.

Neni 46

Tarifat për kryerjen e ekspertimeve ligjore

1. Ekspertimet ligjore dhe ekzaminimet e kryera nga Instituti i Mjekësisë Ligjore kryhen kundrejt tarifave përkatëse.
2. Tarifat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit dhe ministrit përgjegjës për financat.
3. Të ardhurat nga tarifat kalojnë në buxhetin e Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Neni 47

Marrja e objekteve të ekspertimit

1. Eksperti merr për ekzaminim nga organet publike apo subjektet private trupin e kufomës ose pjesë të saj, eshtrat ose kampionet e mostrave biologjike, të cilat i dorëzohen sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në fuqi.
2. Gjatë kohës në të cilën do të kryhen ekzaminimet, Instituti i Mjekësisë Ligjore merr në ruajtje objektet e ekspertimit.
3. Kur objektet e ekspertimit nuk dorëzohen sipas procedurës së caktuar, eksperti nuk procedon me ekspertimin dhe bën shpjegimet përkatëse.

Neni 48

Dorëzimi i kufomës dhe sendeve pas kryerjes së autopsisë

1. Në përfundim të autopsisë kufoma u dorëzohet familjarëve apo të afërmeve të saj në gjendje sa më normale të jetë e mundur, duke respektuar kufomën dhe ndjenjat njerëzore.
2. Tekniku i morgut realizon trajtimin estetik dhe veshjen e kufomës sipas kërkesës nga të afërmit e viktimës.
3. Trajtimi estetik dhe veshja e kufomës kryhet kundrejt tarifave përkatëse, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për financat.
4. Sendet dhe objektet që përbëjnë prova materiale i dorëzohen oficerëve të Policisë Gjyqësore, kundrejt procesverbalit përkatës.

Neni 49

Lëshimi i skedës së vdekjes

Vërtetimi i shkakut të vdekjes konfirmohet nëpërmjet plotësimit të skedës së vdekjes nga eksperti që ka kryer ekzaminimin. Një kopje e skedës i dorëzohet familjarëve, ndërsa një kopje mbahet në arkivën e Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Neni 50

Varrimi i kufomës në raste të veçanta

1. Në raste të veçanta, Instituti i Mjekësisë Ligjore, sipas urdhrorit të gjykatës apo prokurorit, kërkon nga bashkia kompetente varrimin e kufomës, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i urdhrorit, kur:

- a) kufoma apo pjesët e trupit nuk janë identifikuar edhe pas kryerjes së autopsisë dhe të gjitha procedurave të tjera identifikuese;
- b) nëse nuk ka anëtar të familjes që ta pranojnë kufomën apo pjesët e trupit;
- c) nëse anëtarët e familjes refuzojnë ta marrin kufomën e identifikuar apo pjesët e trupit pas njoftimit për të tërhequr kufomën;
- ç) nëse për çfarëdo arsye tjetër nuk është e mundur t'i kthehet anëtarëve të familjes kufoma apo pjesët e trupit për varrim.

2. Bashkia kompetente sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni është bashkia e vendit ku personi i vdekur ka pasur banimin ose qëndrimin e tij të fundit ose ka qenë i regjistruar në gjendjen civile. Në rast se këto vende nuk mund të përcaktohen, kompetente është bashkia e vendit ku ka ndodhur ngjarja.

KREU VII

LLOJET E EKSPERTIMEVE

Neni 51

Ekspertimi mjeko-ligjor

1. Ekspertimi mjeko-ligjor kryhet nga mjeku ligjor i Institutit të Mjekësisë Ligjore.

2. Në rastin e ekzaminimit të personave të gjallë, ekspertimi mjeko-ligjor përfshin ekzaminimin klinik në raste të lëndimeve fizike, cenimit të integritetit seksual, si dhe shqyrtimin e dokumenteve apo akteve të çështjes si dhe të ekzaminimeve tjera klinike mjekoligjore të natyrës penale ose civile si ekzaminime biokimike, imunologjike, imazherike, hormonale, ADN dhe ekzaminime elektrofiziologjike. Dokumentet e çështjes që shqyrtohen gjatë ekspertimit mjeko-ligjor përfshijnë kartelat mjekësore, rekomandimet, recetat, rezultatet e ekzaminimeve imazherike e laboratorike, si dhe gjithë dokumentacionin që ka lidhje me rastin objekt ekspertimi.

3. Ekspertimi mbi bazën e dokumenteve të çështjes realizohet vetëm në rastet kur ekzaminimi fizik i personit është i pamundur për shkaqe objektive dhe:

- a) në dokumentet e një çështjeje mungon mendimi i ekspertit mjekoligjor;
- b) në dokumentet e një çështjeje hetimore ose gjyqësore ndodhen konkluzione kontradiktore të disa ekspertëve;

c) të dhënat hetimore ose gjyqësore nuk përputhen me ato të ekspertimit, në rastet e neglizhencës mjekësore ose mosdhënies së ndihmës nga personeli mjekësor.

4. Në rastin e ekzaminimit të kufomave përfshin autopsinë mjeko-ligjore, ekzaminimin toksikologjik dhe biologjik, ekzaminimin anatomo patologjik dhe ekzaminimin antropologjik.

Neni 52

Ekzaminimi klinik mjeko-ligjor

1. Ekzaminimi klinik mjeko ligjor përfshin ekzaminimin e personave të gjallë për:

a) përcaktimin e mjetit që ka shkaktuar dëmtimin , shkallën e lëndimeve trupore, humbjen e aftësisë për punë, gjendjen shëndetësore, simulimin apo vetëdëmtimin;

b) rastet e veprave penale kundër integritetit seksual të përcaktuara me legjislacionin penal në fuqi;

c) raste për përcaktimin e gjendjes seksuale, si aktiviteti seksual, pjekuria seksuale ose aftësia seksuale;

ç) përcaktimin e shtatëzanisë, ndërprerjes së shtatëzanisë, lindjes, për njohjen e atësisë ose amësisë së një fëmije të lindur brenda ose jashtë martesës;

d) përcaktimin e moshës dhe identitetit të një personi;

dh) vlerësimin e shkallës së konsumimit të alkoolit dhe intoksikimit me lëndë narkotike sipas ekzaminimit toksikologjik;

e) rastet e transplantimit të kundërligjshëm të organeve, indeve dhe qelizave njerëzore.

3. Ekzaminimi klinik mjeko-ligjor kryhet vetëm pasi të informohet i ekzaminuari për natyrën e ekzaminimit që duhet të kryhet dhe pas marrjes së pëlqimit vullnetar prej tij.

4. Në rast të refuzimit për dhënie të pëlqimit referuar paragrafit 3 i këtij neni, ekzaminimi kryhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodit të Procedurës Civile

Neni 53

Autopsia mjeko-ligjore

1. Autopsia mjeko-ligjore kryhet në rastet e vrasjeve, vdekjes së papritur, dëmtimit fizik si pasojë e një vepre penale, shkaktimit të vetëvrasjes, si dhe në çdo rast tjetër të vdekjes kur dyshohet se ka ardhur si pasojë e një vepre penale apo në rastin e zhvarrimit të kufomave.

2. Autopsia mjeko-ligjore e kufomave bëhet sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për autopsitë dhe rregullat procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, si dhe parashikimeve të këtij ligji.

3. Ekspertimet mjeko-ligjore të kufomave kryhen në morgun e Institutit të Mjekësisë Ligjore ose në ambientet e morgjeve pranë institucioneve spitalore.

4. Organi procedues mund të urdhërojë kryerjen e ekzaminimeve mjeko-ligjore jashtë ambienteve përkatëse të Institutit të Mjekësisë Ligjore, në raste të veçanta kur kërkohen ekzaminime të caktuara që nuk ofrohen nga Instituti të Mjekësisë Ligjore me qëllim sigurimin e kushteve të përshtatshme për një procedurë të tillë.

5. Ekspertimi mjeko-ligjor i kufomës si rregull kryhet vetëm në dritë natyrale. Vetëm në raste përjashtimore dhe me miratimin e drejtorit të Institutit, ekspertimi mund të bëhet edhe në dritë artificiale.

Neni 54

Ekspertimi psikiatriko-ligjor

1. Ekspertimet psikiatriko-ligjore kryhen nga mjekte psikiatër të specializuar në fushën e psikiatrisë-ligjore.

2. Objekti i ekspertimit psikiatriko-ligjor është:

a) përcaktimi i përgjegjshmërisë ose papërgjegjshmërisë të personit nën hetim ose të pandehurit;

b) përcaktimi i gjendjes psikike të të dënuarve që paraqesin turbullime psikike gjatë kohës së ekzekutimit të dënimit;

c) përcaktimi i gjendjes mendore të personave gjatë ekzekutimit të masës mjekësore;

d) vlerësimi mbi gjendjen psikike të personit, në rastin e çështjeve civile për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar;

e) përcaktimi i gjendjes psikike të dëshmitarëve dhe të dëmtuarve;

f) përcaktimin e gjendjes psikike për kryerjen e veprimeve juridike.

3. Ekspertimet psikiatriko-ligjore kryhen pranë Institutit. Në raste pamundësie, ekspertimi kryhet edhe në institucione spitalore.

4. Ekspertimi psikiatrik sipas pikës 2 të këtij neni kryhet pasi personi informohet për natyrën e ekzaminimit që duhet të kryhet.

5. Në raste të veçanta, kur ekspertimi i personit nuk është i mundur, ekspertimi psikiatriko-ligjor mund të kryhet dhe në mungesë të personit, mbështetur në dokumentacionin mjekësor dhe ligjor të çështjes.

6. Ekspertimi psikiatriko-ligjor mund të kryhet edhe kur lind nevoja për të kontrolluar përfundimet e një eksperti të mëparshëm, kur ato ngjallin dyshime për saktësinë e tyre.

Neni 55

Ekspertimi toksikologjiko-ligjor

1. Ekspertimet toksikologjiko-ligjore kryhen nga eksperti farmacist ose kimist i specializuar në fushën e toksikologjisë-ligjore.

2. Objekti i ekspertimit toksikologjiko-ligjor është:

a) e përcaktimi cilësor dhe sasior i substancave alkoolike bazuar në mostrat biologjike si: gjak, lëng vitroz, urinë në persona të gjallë dhe kufoma ;

b) përcaktimi i llojit dhe sasisë së lëndëve narkotike dhe psikotrope në persona të gjallë dhe kufoma në mostra biologjike si: gjak dhe urinë;

c) përcaktimi i sasisë së gazeve helmuese në persona të gjallë dhe kufoma , në mostrat biologjike të gjakut;

d) përcaktimi illojit të pesticideve në mostra biologjike (gjak, urinë, lavazh gastrik) në personat e hospitalizuar dhe mostra biologjike të kufomave (inde, gjak, urinë, lavazh gastrik).

e) përcaktimi cilësor i lëndëve metalore helmuese të rënda.

3. Eksperti toksikologo-ligjor në punën e tij asistohet nga specialisti teknik i lartë laborator.
4. Me kërkesë të ekspertit mjeko-ligjor kryhet ekzaminimi toksikologjik mbi mostrat biologjike të marra gjatë autopsisë, apo ekzaminimit të personave të dhunuar. Raporti i ekzaminimit toksikologjik bëhet pjesë e aktit të ekspertimit mjeko-ligjor.

Neni 56

Ekspertimi biologjiko-ligjor

1. Ekspertimet biologjiko-ligjore kryhen nga ekspertë biolog të specializuar në fushën e biologjisë-ligjore.
2. Objekti i ekspertimit biologjiko-ligjor është:
 - a) përcaktimi i karakteristikave individuale dhe krahasuese të personave objekt ekspertimi dhe mostrave të ekzaminuara;
 - b) përcaktimi i atësisë apo amësisë në çështjet me natyrë civile.
3. Ekspertimi biologjiko-ligjor bëhet nëpërmjet ekzaminimit të mostrave biologjike: inde të buta, gjak, urinë, qime trupore, sekrecione biologjike apo eshtra, si dhe provave materiale në të cilat mund të gjenden mbetje biologjike.
4. Me kërkesë të ekspertit mjeko-ligjor kryhet ekzaminimi biologjik mbi mostrat biologjike të marra gjatë autopsisë, apo ekzaminimit të personave të dhunuar. Raporti i ekzaminimit biologjik bëhet pjesë e aktit të ekspertimit mjeko-ligjor.

Neni 57

Ekspertimi antropologo-ligjor

1. Ekspertimi antropologo-ligjor kryhet nga mjeku i specializuar në antropologji ligjore.
2. Objekti i ekspertimit antropologo-ligjor është:
 - a) ekzaminimi i mbetjeve mortore kockore me qëllim identifikimin e personit që i përkasin mbetjet;
 - b) ekzaminimi i mbetjeve mortore kockore me qëllim përcaktimin e mekanizmit dhe shkakut të vdekjes nëpërmjet shenjave dhe gjurmëve të lëna në mbetjet objekt ekspertimi; përcaktimi i kohës së vdekjes, për aq sa është mundur.
3. Ekspertimi antropologo-ligjor mund të bëhet edhe mbi dokumentet e çështjes. Ekspertimi mbi dokumentet e çështjes realizohet vetëm në rastet kur ekzaminimi fizik i personit është i pamundur për shkaqe objektive dhe:
 - a) në dokumentet e një çështjeje mungon mendimi i ekspertit mjekoligjor;
 - b) në dokumentet e një çështjeje hetimore ose gjyqësore janë dhënë konkluzione kontradiktore të disa ekspertëve;
 - c) të dhënat hetimore ose gjyqësore nuk përputhen me ato të ekspertimit, në rastet e neglizhencës në trajtimin mjekësor ose mosdhënies së ndihmës nga personeli mjekësor.

Neni 58

Ekspertimi anatomopatolog-ligjor

1. Ekspertimi anatomopatolog-ligjor kryhet nga një mjek i specializuar në anatomi patologjiko-ligjore.

2. Ekspertimi anatomopatologjik ligjor kryhet me kërkesë të ekspertit mjekologjor në përfundim të autopsisë mjekologjore.

3. Ekspertimi anatomopatologjik-ligjor është procedura që konsiston në ekzaminimin mikroskopik të mostrave biologjike, pjesëza të gjithë indeve të trupit të kufomës, me qëllim përcaktimin e shkakut të vdekjes;

4. Eksperti anatomopatologo-ligjor në punën e tij asistohet nga një specialist teknik i lartë laborator.

5. Raporti i ekspertit anatomopatologo-ligjor bëhet pjesë e aktit të ekspertimit mjeko-ligjor.

KREU VIII

MARRËDHËNIET ME ORGANET PROCEDUESE DHE ME TË TRETËT

Neni 59

Marrëdhëniet me organin procedurës

1. Organi procedurës që ka caktuar ekspertimin ka të drejtë të kërkojë nga eksperti ligjor çdo informacion lidhur me ecurinë e procesit të ekspertimit.

2. Ky rregull zbatohet, për aq sa është e mundur, edhe kur kërkues janë palët private.

Neni 60

Marrëdhëniet me personat e tretë

1. Çdo person detyrohet të lejojë ekspertin të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për realizimin e ekspertimit, sipas vendimit të organit procedurës dhe legjislacionit në fuqi.

2. Çdo person objekt i ekspertimit bashkëpunon me ekspertin për deklarimin e informacionit të nevojshëm që i shërben ekspertimit.

3. Çdo person ka të drejtë të kundërshtojë veprimet e ekspertit duke paraqitur shkaqet pranë organit që ka kërkuar ekspertimin ose duke paraqitur ankim pranë drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Neni 61

Përgjegjësitë në procesin e ekspertimit

1. Eksperti ligjor, që kryen veprimtarinë në kundërshtim me ligjin, mban përgjegjësi vetjake për dëmin që u shkakton palëve në proces, si dhe për dëmin ndaj të tretëve.

2. Kur veprimet e ekspertit përbëjnë vepër penale, ndiqet penalisht sipas legjislacionit penal.

Neni 62

Marrëdhëniet me të tretët

1. Eksperti ligjor ka të drejtë të kërkojë informacionin e nevojshëm për procedurat e ekspertimit, nga organet publike, entet publike ose nga personat juridikë dhe fizikë që zotërojnë informacionin e kërkuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Informacioni i kërkuar i jepet brenda 5 (pesë) ditë pune nga marrja e kërkesës zyrtare dhe jo më vonë se 2 (dy) ditë pune kur informacioni kërkohet nëpërmjet komunikimit me postë elektronike.

3. Të dhënat e marra në përputhje me këtë nen trajtohen në përputhje me detyrimin e konfidencialitetit dhe sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 63

Bashkëpunimi me organet e tjera

1. Eksperti ligjor për kryerjen e detyrave të ngarkuara bashkëpunon, por pa u kufizuar, me zyrën e gjendjes civile, Institutin e Policisë Shkencore dhe strukturat e tjera të Policisë së Shtetit.

2. Organet publike janë të detyruara të mbështesin dhe ndihmojnë ekspertin ligjor sa herë që kërkohet ndihma e tyre, kur çmohet se ekspertimi nuk mund të kryhet pa ndihmën e tyre.

3. Rregulla të hollësishme për mënyrën e bashkëpunimit dhe mbështetjen e ekspertëve ligjorë përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe ministrave përgjegjës, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

KREU IX

TRANSFERIMI DHE PEZULLIMI

Neni 64

Transferimi i përkohshëm

1. Eksperti mund të transferohet përkohësisht brenda shërbimit, për nevoja të punës dhe në interes të shërbimit të mjekësisë ligjore.

2. Transferimi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet në qendrën më të afërt të ushtrimit të veprimtarisë në nivel qendror apo vendor, jo më shumë se 2 herë në vit, me kohëzgjatje deri në 3 (tre) muaj secila. Në përfundim të periudhës së transferimit, eksperti rikthehet në strukturën ku është emëruar.

3. Transferimi sipas këtij neni, bëhet me urdhër të drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

4. Rregulla të hollësishme për transferimin e përkohshëm, sipas këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit, me propozim të drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Neni 65

Transferimi i përhershëm

1. Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i ekspertit brenda shërbimit të mjekësisë ligjore në nivel qendror apo vendor, në rastet e:

a) shmangies së konflikteve të vazhdueshme të interesit;

b) mbylljes ose ristrukturimit të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë ku eksperti ushtron funksionin e tij.

2. Eksperti ligjor mund të refuzojë transferimin në rastet kur:

a) gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur;

b) vendi i transferimit ndodhet më shumë se 45 (dyzetë e pesë) kilometra nga vendbanimi i tij. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera përbën shkak për largim nga detyra.

3. Transferimi i përhershëm bëhet me urdhër të drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

4. Rregulla të hollësishtme për transferimin e përhershëm, sipas këtij neni, përcaktohen me urdhër të ministrit, me propozim të Drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Neni 66

Pezullimi

1. Eksperti ligjor mund të pezullohet përkohësisht nga detyra nga drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore, kur:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;

b) ndaj tij ka filluar një procedurë për heqjen e zotësisë juridike për të vepruar;

c) deklarohet i zhdukur me vendim të formës së prerë të gjykatës, deri në shfaqjen e personit apo deklarimit të vdekjes me vendim të formës së prerë të gjykatës;

ç) nëse ndodhet në gjendje konflikti i interesit të vazhdueshëm, deri në transferimin e tij;

d) nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga eksperti ligjor ndaj të cilit ka filluar një procedim disiplinor, pengon hetimin administrativ apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij. Në këtë rast pezullimi vendoset deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

2. Kundër urdhrorit për pezullimin nga detyra, eksperti mund të bëjë ankim në gjykatën administrative kompetente brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga data e njoftimit të tij.

Neni 67

Efektet e pezullimit

1. Në përfundim të afatit apo zhdukjes së shkakut të pezullimit, përveçse kur vendoset largimi nga detyra, sipas këtij ligji, eksperti rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës ose në rast se pozicioni i mëparshëm është i plotësuar përfundimisht, ai transferohet në qendër tjetër të ushtrimit të veprimtarisë në nivel qendror apo vendor.

2. Periudha e pezullimit në rastet e parashikuara nga shkronjat “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 66 të këtij ligji, llogaritet si vjetërsi pune në profesion.

3. Eksperti ligjor gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë. Në rastet e parashikuara nga shkronjat “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 66 të këtij ligji, përfiton 50% të pagës së plotë. Në rastin e parashikuar nga shkronja “a” e pikës 1 të nenit 66 të këtij ligji, kur vendoset pushimi i çështjes apo pafajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë, ekspertit i jepet paga e plotë që nga momenti i pezullimit.

KREU X
VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL I EKSPERTIT LIGJOR

Neni 68
Vleresimi në punë

Të gjithë ekspertët ligjor i nënshtrohen vlerësimit etik dhe profesional mbi ecurinë e procesit të punës në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë ligj.

Neni 69
Parimet e vlerësimit

Vlerësimi etik dhe profesional bazohet në parimet e mëposhtme:

- a) parimi i paanshmërisë, sipas së cilit procesi i vlerësimit nuk duhet të ndikojë apo të ndërhyjë në paanësinë e ekspertit;
- b) parimi i meritokracisë, sipas të cilit vlerësimi i veprimtarisë së ekspertit bëhet duke i dhënë rëndësinë më të madhe vlerave profesionale dhe cilësisë në punë;
- c) parimi i efikasitetit, sipas të cilit vlerësimi i veprimtarisë së shërbimit të mjekësisë ligjore bëhet nëpërmjet një procesi në afate kohore të arsyeshme, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- ç) parimi i konfidencialitetit, sipas të cilit subjektet e ngarkuara me detyrën e vlerësimit janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të ekspertit që vlerësohet, si dhe të dhënat personale, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 70
Qëllimi i vlerësimit të ekspertit ligjor

Qëllimi i vlerësimit etik dhe profesional i ekspertit ligjor është:

- a) të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme etikën dhe aftësitë profesionale;
- b) të vendosë standarde të qëndrueshme për cilësinë e veprimtarisë së mjekësisë ligjore;
- c) të informojë Institutin e Mjekësisë Ligjore në lidhje me nevojat për trajnim të ekspertëve dhe për të lehtësuar planifikimin e trajnimit të tyre;
- ç) të identifikojë ekspertët që mund të kenë aftësi të veçanta profesionale për shërbimin e mjekësisë ligjore;
- d) të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të punës së ekspertëve.

Neni 71
Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi kryhet sipas kriterëve të mëposhtme:

- a) aftësisë profesionale të ekspertit;
- b) aftësisë organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të ekspertit;
- ç) aftësisë personale dhe angazhimit profesional.

Neni 72

Aftësitë profesionale të ekspertit

1. Me anë të kriterit të aftësisë profesionale vlerësohet aftësia profesionale e tij në drejtim të njohurive profesionale, teorike dhe praktike në fushën përkatëse të mjekësisë ligjore.

2. Aspekti i njohurive, sipas pikës 1 të këtij neni, vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e ekspertit për të realizuar ekspertimin dhe duke u bazuar në tregues të tillë, si: aftësia e përgjithshme për të kryer ekspertimin në mënyrë të saktë shkencore, për të kryer ekspertimin në kohë sa më të shpejtë duke shmangur vonesa për organin procedures, për të shmangur dëmtimin e provave dhe aftësinë për të bashkëpunuar me institucionet publike apo me çdo subjekt tjetër në kohë të shpejtë.

Neni 73

Aftësitë organizative

1. Me anë të kriterit të aftësisë organizative vlerësohet aftësia e ekspertit për të përballuar ngarkesën e punës si dhe aftësia për të administruar aktet e ekspertimit duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen prej tij dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit.

2. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo ekspertimi dhe në rendimentin e përfundimit të ekspertimit dhe hartimit të aktit të ekspertimit.

3. Aftësia e ekspertit për të kryer në mënyrë të efektshme ekspertimet matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme për realizimin e llojit të ekspertimit brenda afatit kohor të përcaktuar në udhëzuesin për metodat e punës.

Neni 74

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

1. Me anë të kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale vlerësohet aftësia e ekspertit për etikën në punë dhe paanësinë.

2. Etika në punë e ekspertit në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion matet duke u bazuar në treguesit e dalë nga burimet e vlerësimit, të tilla si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, si dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore.

3. Paanësia e ekspertit në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit matet duke u bazuar në tregues të tillë, si numri i kërkesave për mospranimin e ekspertimit dhe heqje dorë nga ekspertimi për të cilin është caktuar.

Neni 75

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

1. Me anë të kriterit të aftësisë personale dhe angazhimit profesional vlerësohen aftësitë e komunikimit, aftësia për të bashkëpunuar me kolegët, palët e treta dhe gatishmëria për punë në grup, si dhe aftësia për t'u angazhuar në trajnime profesionale.

2. Aftësia e komunikimit matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit të qartë dhe transparent me organet e procedimit, subjektet e tjera, të tretët, në respektim edhe të parimit të konfidencialitetit.

3. Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët dhe gatishmëria në grup matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit dhe bashkëveprimit me kolegët apo personelin ndihmës e administrativ, si dhe shkëmbimit të njohurive apo të përvojës profesionale me ta.

4. Gatishmëria për t'u angazhuar në trajnime profesionale matet duke u bazuar në tregues të tillë, si pjesëmarrja e ekspertit në trajnimet vazhduese, pjesëmarrja në trajnime të tjera profesionale, publikimet shkencore dhe pjesëmarrja në veprimtari shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Neni 76

Burimet e vlerësimit

Vlerësimi i ekspertëve ligjorë bazohet në këto burime:

- a) të dhënat statistikore për veprimtarinë e shëbrimit të mjekësisë ligjore;
- b) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj ekspertit;
- c) informacioni nga institucioni trajnues, që vërteton pjesëmarrjen dhe ecurinë në formimin vazhdues apo në veprimtaritë të tjera trajnuese;
- ç) vendimet përfundimtare për masat disiplinore, që janë dhënë ndaj ekspertit, dhe nëse masat disiplinore janë shuar ose jo;
- d) mendimi i drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore;
- dh) qëndrimet e gjykatës lidhur me ankimet ndaj ekspertit ligjor;
- e) çdo të dhënë tjetër, që tregon aftësitë e kualifikimit profesional të ekspertit.

Neni 77

Nivelet e vlerësimit

1. Vlerësimi i ekspertit ligjor kryhet, sipas këtyre niveleve:

- a) “Shkëlqyeshëm” në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi shumë të larta;
- b) “Shumë mirë” në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mbi mesataren;
- c) “Mirë” në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mesatare;
- ç) “Mjaftueshëm” në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi nën mesataren;
- d) “I pamjaftueshëm” në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi të dobët.

2. Vlerësimi i përgjithshëm “Shkëlqyeshëm” jepet në ato raste kur eksperti është vlerësuar “Shkëlqyeshëm” për të katërta kriteret.

3. Vlerësimi i përgjithshëm “Shumë mirë” jepet vetëm në ato raste kur eksperti vlerësohet “Shumë mirë” për tri kriteret dhe “mirë” për njërin prej tyre. Në çdo rast, kriteret “Aftësitë profesionale” dhe “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” duhet të jenë vlerësuar “Shumë mirë”.

4. Vlerësimi i përgjithshëm “Mirë” jepet në rastin kur aftësitë e ekspertit vlerësohen “Mirë” për dy kritere dhe “Mjaftueshëm” për dy kriteret e tjera. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur ka barazi në vlerësimin e kritereve në nivelet “Mjaftueshëm” dhe “I pamjaftueshëm”.

5. Vlerësimi i përgjithshëm “I pamjaftueshëm” jepet në këto raste, kur:

- a) eksperti vlerësohet “I pamjaftueshëm” për të paktën në tri kritere;
- b) eksperti vlerësohet “I pamjaftueshëm” për kriteret “Aftësitë profesionale” dhe “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” dhe jo më shumë se “Mirë” për dy kriteret e tjera.

Neni 78

Kriteret për vlerësimin e drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore

Vlerësimi i veprimtarisë së drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore kryhet bazuar në këto kritere:

- a) aftësisë drejtuese dhe organizative;
- b) aftësisë së komunikimit.

Neni 79

Aftësitë drejtuese dhe organizative

1. Me anë të kriterit të aftësive drejtuese dhe organizative vlerësohen aftësitë e për organizimin e qartë të veprimtarive administrative nëpërmjet dhënies së vendimeve dhe urdhrave për të siguruar respektimin e afateve dhe përdorimin sa më të mirë të burimeve të disponueshme, si dhe transparencën.

2. Kriteri i aftësive drejtuese dhe organizative matet duke u bazuar në treguesit që kanë lidhje me mirorganizimin e punës dhe shpërndarjen e detyrave, komunikimin e prioriteteve, aftësinë për të përdorur me efektshmëri burimet financiare dhe njerëzore, marrjen e masave për plotësimin e vendeve vakante në kohë të shpejtë, krijiminte ambienteve dhe infrastrukturës së përshtatshme, në përputhje me nevojat e punës.

3. Përfshirja e drejtorit në veprimtari ndër institucionale për përmirësimin e shërbimit të mjekësisë ligjore ose në trajnime profesionale për drejtimin dhe organizimin e tij vlerësohet me përparësi në matjen e këtij kriteri.

Neni 80

Aftësitë komunikuese

1. Me anë të kriterit të aftësisë komunikuese vlerësohet aftësia e drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore për komunikim të qartë, në kohë dhe transparent.

2. Ky kriter matet duke u bazuar në treguesit që kanë lidhje me bashkëpunimin efektiv dhe në kohë me Ministrinë e Drejtësisë, organet e procedurës, Avokatin e Popullit, Institutin e Policisë Shkencore dhe strukturat e tjera të Policisë së Shtetit, njësitë e qeverisjes vendore, apo me çdo institucion ose subjekt tjetër, si dhe komunikimin me publikun dhe të tretët.

Neni 81

Burimet e vlerëimit për veprimtarinë e drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore

- Vlerësimi i veprimtarisë së drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore bazohet në këto burime:
- a) të dhëna statistikore për funksionimin e shërbimit të mjekësisë ligjore në 5 (pesë) vitet e fundit;
 - b) vendimmarrjen e tij në zbatim të kompetencave drejtuese dhe menaxheriale;
 - c) çdo dokument, i cili tregon aftësitë e komunikimit të tij me publikun dhe të tretët;
 - ç) të dhëna për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj tij në këtë cilësi;
 - d) vendime përfundimtare për masa disiplinore për shkak të detyrës si drejtor i Institutit të Mjekësisë Ligjore, pavarësisht nëse masa disiplinore është shuar ose jo;
 - dh) çdo burim tjetër që evidenton veprimtarinë profesionale të drejtorit.

Neni 82

Nivelet e vlerësimit

1. Vlerësimi i veprimtarisë së drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore kryhet sipas këtyre niveleve:
 - a) “Shumë mirë” në rastin e veprimtarisë drejtuese me cilësi mbi mesataren;
 - b) “Mirë” në rastin e veprimtarisë drejtuese me cilësi mesatare;
 - c) “Mjaftueshëm” në rastin e veprimtarisë drejtuese nën mesatare.
2. Vlerësimi i përgjithshëm “Shumë mirë” jepet nëse veprimtaria drejtuese vlerësohet “Shumë mirë” në të dyja kriteret. Vlerësimi i përgjithshëm “Mjaftueshëm” jepet nëse veprimtaria drejtuese vlerësohet “Mjaftueshëm” të paktën në një prej kriterëve. Në rastet e tjera veprimtaria drejtuese vlerësohet “Mirë”.

Neni 83

Periudha e vlerësimit

1. Eksperti ligjor vlerësohet 1 herë në 2 vjet gjatë 15 viteve të para të përvojës profesionale si ekspert ligjor.
2. Eksperti ligjor vlerësohet 1 herë në 5 vjet pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si ekspert ligjor.
3. Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore vlerësohet të paktën 1 herë gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 84

Procedura e vlerësimit

1. Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore jo më vonë se muaji nëntor i çdo viti, miraton programin, që përcakton listën e ekspertëve për të cilët do të kryhet vlerësimi përgjatë vitit pasardhës dhe periudhën e vlerësimit. Programi publikohet në faqen zyrtare të Institutit të Mjekësisë Ligjore.
2. Ekspertët njoftohen në çdo rast, jo më vonë se 3 javë nga momenti i vlerësimit sipas përcaktimeve të kësaj dispozite.

3. Eksperti kryen vlerësimin etik dhe profesional të tij sipas formularit standard të vendosur nga drejtori, brenda 3 (tre) javëve nga marrja e njoftimit, nëpërmjet të cilit eksperti:

- a) vlerëson detyrat e ushtruara përkundrejt kritereve vlerësuese;
- b) paraqet një analizë të të dhënave statistikore që lidhen me veprimtarinë e tij;
- c) përshkruan masat që ka ndërmarrë për përmbushjen e objektivave të përcaktuara në vlerësimin e mëparshëm, nëse ka;
- ç) përshkruan shkallën, në të cilën janë përmbushur këto objektiva, duke dhënë edhe shpjegimin përkatës;
- d) përshkruan objektivat për zhvillimin e tij profesional për vlerësimin e ardhshëm të tij;
- dh) përshkruan nevojat për trajnim dhe, nëse ka, rrethanat të cilat përbëjnë pengesë për zhvillimin e tij profesional dhe propozon zgjidhje konkrete për periudhën e ardhshme të vlerësimit.

4. Eksperti dorëzon formularin e plotësuar pranë drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

5. Drejtori jep mendimin për veprimtarinë e ekspertit brenda 10 ditëve nga dorëzimi i formularit. Në mendimin e drejtorit përshkruhet veprimtaria e ekspertit dhe vlerësimi i tij për këtë veprimtari, sipas kritereve të vlerësimit, duke u bazuar në nivelet e vlerësimit të parashikuara në këtë ligj. Gjithashtu, në mendimin e drejtorit pasqyrohet një analizë e të dhënave statistikore të veprimtarisë së ekspertit.

6. Brenda 3 (tre) ditëve nga njoftimi i mendimit të drejtuesit, eksperti gëzon të drejtën për t'u dëgjuar dhe paraqet kërkesë për zhvillimin e një takimi.

7. Drejtori zhvillon takimin me ekspertin brenda 2 (dy) javëve nga data e depozitimit të kërkesës dhe merr masat për pasqyrimin e takimit në procesverbal, i cili i bashkëlidhet mendimit të dhënë.

8. Jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga realizimi i takimit, drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore merr vendimin për vlerësimin, të cilin i'a njofton brenda 20 (njëzetë) ditëve ekspertit.

9. Në rastet kur eksperti vlerësohet "i mjaftueshëm", i ulet paga me 5% gjatë 2 (dy) viteve kalendarike pas këtij vlerësimi. Në rastet kur eksperti vlerësohet "i pamjaftueshëm", shkarkohet nga detyra.

10. Eksperti, kur nuk është dakord me vendimin për vlerësimin e tij, ka të drejtë ta ankimojë në gjykatën administrative kompetente, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

11. Vlerësimi i drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore kryhet nga ministri. Procedura dhe afatet për vlerësimin e drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore përcaktohet me urdhër të ministrit.

KREUXI

RREGULLAT E SJELLJES DHE PROCEDIMI DISIPLINOR

Neni 85

Respektimi i rregullave të sjelljes dhe disiplinës

1. Ekspertët ligjorë kryejnë detyrën me përgjegjësi dhe profesionalizëm dhe garantojnë zbatimin e rregullave të sjelljes etike dhe deontologjisë mjekësore.
2. Eksperti duhet të jetë i kujdesshëm kur pranon dhurata që mund t'i ofrohen, brenda kufirit ligjor.
3. Eksperti duhet të shmangë shoqërimin me individë që kanë lidhje interesi lidhen me subjekte objekt të ekspertimit, për aq kohë sa nuk është dhënë një vendim përfundimtar.
4. Eksperti ka detyrimin që të ruajë dinjitetin e detyrës. Eksperti duhet të ketë paraqitje të rregullt, të ruajë dhe të respektojë detyrën e mjekut, në përputhje me natyrën e punës për të përfaqësuar denjësisht institucionin.
5. Eksperti duhet të jetë i kujdesshëm për të shmangur situata të dyshimta njëanshmërie, në rast të lidhjeve të ngushta familjare apo sociale me organet e procedimit palë në një çështje, të cilat mund të përbëjnë shkaqe përjashtimi.
6. Në ushtrimin e detyrave të tij eksperti nuk lejon që interesat e tij personalë dhe financiarë të bien ndesh me pozicionin e tij, shmang konfliktin e interesave dhe nuk shfrytëzon pozitën për interesin personal.
7. Eksperti shmang çdo sjellje të papërshtatshme, që bie në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e sjelljes, si edhe ato veprime që mund të dëmtojnë ose të krijojnë dyshime mbi figurën e tij profesionale dhe morale.
8. Në ushtrimin e detyrave të tij, eksperti tregohet i kujdesshëm për të parandaluar shkeljet e ligjit nga persona të tretë.
9. Eksperti ushtron detyrën e tij në mënyrë korrekte, duke respektuar orarin e punës, përkrahur frymën e bashkëpunimit, mbështetjes, besimit reciprok dhe mirëkuptimit mes personelit, në çdo kohë dhe çdo situatë.
10. Eksperti shmang çdo sjellje e cila bie ndesh me rregullat e parashikuara në këtë ligj, aktet nënligjore si dhe çdo akt tjetër i cili parashikon detyrime për ekspertët mjekoligjor.
11. Eksperti nuk duhet të komentojë në ambiente publike mbi sjelljen apo ecurinë në punë të kolegëve të tij, apo të dëmtojë imazhin e institucionit. Nëse eksperti kanstaton shkelje nga kolegët duhet të raportojë në organet përkatëse.
12. Në ushtrimin e detyrave të tij, eksperti komunikon në gjuhë formale me personat me të cilët ka kontakt dhe zbaton rregullat e mirësjelljes së përgjithshme.
13. Ekspertit i ndalohet:
 - a) mbajtja e pijeve alkoolike në zyrat dhe mjediset e institucionit;
 - b) konsumimi i pijeve alkoolike, si brenda, ashtu dhe jashtë institucionit, gjatë kohëzgjatjes normale të punës.
14. Eksperti nuk duhet të angazhohet në veprimtari të jashtme që pengon kryerjen e detyrës së tij ose që kërkon një angazhim, mendor a fizik të tij, që e bën të vështirë kryerjen e detyrës ose është vazhdim i kësaj detyre, që cenon, në çfarëdo mënyre, imazhin e ekspertëve të Institutit të Mjekësisë Ligjore. Kryerja e veprimtarive të jashtme duhet t'i njoftohet paraprakisht drejtuesit të institucionit dhe njësisë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore.
15. Në rast dyshimi për kualifikimin e një veprimtarie si të lejueshme ose jo, eksperti këshillohet me njësinë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit.
16. Eksperti që nuk respekton apo shkel parimet e etikës dhe të sjelljes profesionale, kur veprimet e tyre nuk përbëjnë vepër penale, ndëshkohen me masat disiplinore.

17. Rregulla më të hollësishme mbi sjelljen, etikën, komunikimin, veshjen dhe disiplinën parashikohen në Kodin e Etikës dhe Sjelljes, i cili miratohet me udhëzim të drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

18. Parashikimet e mësipërme zbatohen edhe për drejtorin dhe zëvendësdrejtorin e Institutit.

Neni 86

Ankesat

1. Çdo person fizik ose juridik, si dhe organi procedues ka të drejtë t'i paraqesë drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore ankesa të arsyetuara me shkrim ekspertët ligjorë.

2. Në rastet kur ka të dhëna të besueshme që eksperti mund të ketë kryer shkelje disiplinore, çdo funksionar publik që ka dijeni duhet të informojë drejtorin.

3. Drejtori ka detyrimin të shqyrtojë të gjitha ankesat, përveç atyre anonime. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë ruajtjen e konfidencialitetit.

4. Drejtori i konfirmon ankuesit marrjen e ankesës brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Drejtori i njofton ankuesit vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin e hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e vendimit përkatës.

5. Tërheqja e ankesës nga ankuesi nuk sjell arkivimin e ankesës dhe mbylljen e hetimit të filluar nëse drejtori vlerëson që ka shkaqe të mjaftueshme për kryerjen e hetimit me iniciativën e tij.

6. Ankesat mund të bëhen brenda 1 (një) viti nga data e sjelljes ose veprimit të ekspertit apo nga data e konstatimit të shkeljes, por në çdo rast jo më vonë se 2 (dy) vjet nga momenti i kryerjes së saj. Pas kalimit të këtij afati, ankuesi ka të drejtë të kërkojë pranë drejtorit rivendosjen në afat në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

7. Formularët e ankesave publikohen në faqen zyrtare të Institutit dhe të ministrisë.

Neni 87

Fillimi i hetimit disiplinor

1. Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore vendos të fillojë hetimin për shkeljen e pretenduar ose të arkivojë një ankesë brenda 3 (tre) muajve nga marrja e ankesës.

2. Drejtori brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e marrjes së vendimit për fillimin e hetimit, fillon procedimin disiplinor duke i paraqitur komisionit disiplinor raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore ose merr vendim për mbylljen e hetimit.

3. Drejtori mund të zgjasë afatin e hetimit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni në raste komplekse për arsye të shtimit ose ndryshimit të objektit të hetimit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

4. Në rastet kur pas kalimit të afateve të parashikuara në pikat 2 ose 3 të këtij neni dalin prova të reja, mbi bazën e të cilave ka shkaqe të arsyeshme të besohet se shkelja mund të ketë ndodhur, drejtori riçel hetimin me kushtin që të mos jenë parashkruar afatet sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 88

Fillimi i hetimeve kryesisht

1. Drejtori ka të drejtë të fillojë hetimin kryesisht bazuar në të dhëna, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se mund të jetë kryer shkelja.
2. Drejtori nxjerr urdhër të arsyetuar për fillimin e hetimit kryesisht, duke parashtruar rrethanat faktike të verifikueshme. Urdhri në çdo rast i njoftohet edhe ekspertit ligjor.

Neni 89

Bashkimi i hetimeve, shtimi dhe ndryshimi i objektit të hetimit

1. Në rast se gjatë hetimit ngrihen dyshime të arsyeshme se mund të ketë ndodhur një shkelje tjetër, drejtori urdhëron shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit në zbatim të nenit 87 të këtij ligji dhe njofton ankuesin dhe ekspertin, sipas rastit.
2. Drejtori bashkon hetimet në rastet kur konstaton se ankesat ose hetimet e filluara u referohen të njëjtave fakte ose të njëjtit ekspert.

Neni 90

Pezullimi i hetimeve

1. Drejtori urdhëron pezullimin e hetimit disiplinor kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil:
 - a) në të cilin njëra nga palët është eksperti ligjor; si dhe
 - b) kur shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte për të cilat do të merret vendimi.
2. Hetimi pezullohet deri në dhënien e vendimit të formës së prerë nga autoriteti përgjegjës.
3. Ankuesi, eksperti, gjykata, prokuroria dhe komisioni disiplinor përkatës njoftohen me shkrim për urdhrin e pezullimit. Gjykata, prokuroria ose institucione të tjera i dërgojnë drejtorit pa vonesë çdo vendim që merret gjatë hetimit e procesit përkatës.
4. Vendimi gjyqësor i formës së prerë, në favor të ekspertit ligjor, nuk pengon hetimin për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të tij.
5. Pezullimi i hetimeve ndërpret afatet e parashkrimit të parashikuara në këtë ligj.

Neni 91

Të drejtat e ekspertit ligjor gjatë hetimit

1. Eksperti ligjor ka të drejtë të njohë dosjen e hetimit në atë masë që nuk cenon sekretin e hetimit.
2. Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore mund të kërkojë nga eksperti informacione, dokumente ose çdo provë që është e nevojshme për hetimin.
3. Drejtori i njofton ekspertit ose përfaqësuesit të tij vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin e hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit.

Neni 92

Ecuria e hetimeve

1. Objekti i hetimit tregon qartë elementet e shkeljes së pretenduar, sipas përcaktimeve në urdhrin për fillimin e hetimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore thërret dëshmitarë dhe mbledh të dhëna, dokumente dhe prova nga gjykata, prokuroria, institucione të tjera shtetërore, organizata, dëshmitarë dhe/ose nga eksperti ligjor, dhe ndërmerr veprime të nevojshme për të hetuar dhe përcaktuar nëse shkelja e pretenduar ka ndodhur.

3. Kur vlerësohet se marrja në pyetje e ekspertit ligjor, dëshmitarëve ose personave të tjerë paraqet rëndësi për hetimin, i njofton ata lidhur me kohën dhe vendin e seancës së marrjes në pyetje.

2. Drejtori merr masa për dokumentimin e seancës së marrjes në pyetje, sipas rregullave të parashikuara në këtë nen. Regjistrimi audio i seancës së marrjes në pyetje përmbledhet në procesverbal dhe zbardhet, me kërkesë të palëve. Eksperti ligjor nënshkruan procesverbalin e marrjes në pyetje, si dhe transkriptimin e regjistrimit audio.

4. Regjistrimi audio, transkriptimi i tij, si dhe procesverbali i seancës së marrjes në pyetje bëhen pjesë e dosjes së hetimit.

Neni 93

Kërkesat në lidhje me mbledhjen e provave nga institucionet e tjera

1. Çdo organ publik, person fizik ose juridik përmbush në kohë kërkesat për marrje informacioni, dokumente ose prova të tjera që lidhen me hetimin, brenda afateve kohore të arsyeshme, të përcaktuara nga drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore në kërkesën e tij, me përjashtim të rasteve kur dhënia e tyre është e kufizuar me ligj.

2. Drejtori përsërit kërkesën në rastin kur personi ose subjekti, të cilit i drejtohet kjo kërkesë, nuk e përmbush atë brenda afatit të caktuar, duke informuar në rastin e personit juridik edhe drejtuesin e tij. Në rastin kur personi ose subjekti, të cilit i drejtohet kjo kërkesë, nuk përmbush kërkesën e përsëritur brenda afatit të caktuar, drejtori njofton organin përgjegjës disiplinor.

3. Nëse gjatë hetimit disiplinor të ekspertit ligjor ekziston nevoja thelbësore dhe specifike për të marrë dokumente, informacione, të cilat mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, drejtori mund t'i kërkojë gjykatës me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë, lëshimin e një urdhri për dhënien e informacionit të kërkuar për ekspertin ligjor. Vendimi i gjykatës merret nga gjyqtari i vetëm në dhomë këshillimi, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dorëzimi i kërkesës.

4. Kërkesa duhet të përmbajë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se eksperti ka kryer shkeljen, si dhe se informacioni i kërkuar është thelbësor për të përcaktuar nëse shkelja ka ndodhur.

Neni 94

Dokumentacioni i hetimit

1. Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore dokumenton çdo veprim hetimor me procesverbal.

2. Procesverbali duhet të përmbajë:

a) emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës që kryen veprimin;

- b) datën e kryerjes së veprimit;
- c) subjektin dhe objektin e veprimit;
- ç) pjesëmarrësit;
- d) përshkrimin e hollësishëm të veprimit të kryer;
- dh) nënshkrimin e personave që marrin pjesë në këto veprime.

3. Me përfundimin e hetimit, harton raportin e hetimit, i cili përmban të paktën:

- a) emrin dhe mbiemrin e hartuesve të raportit;
- b) shkaqet për fillimin e hetimit, subjektin dhe objektin e hetimit, sipas përcaktimeve të bëra në urdhrin për fillimin e hetimit, ndryshimin ose shtimin e objektit të hetimit;
- c) veprimet e kryera gjatë hetimit;
- ç) përmbledhjen e deklaratave të ekspertit ligjor përkatës dhe të personave të tjerë ose institucioneve;
- d) parashtrimin e fakteve të pranuar dhe të papranuara, ashtu si edhe të provave, si dhe vlerësimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre;
- dh) analizën ligjore të fakteve të pranuar që mbështesin përfundimin se shkelja disiplinore e pretenduar është kryer ose se hetimi duhet mbyllur;
- e) propozimin për mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor dhe propozimin për caktimin e masës disiplinore

Neni 95

Përfundimi i hetimit

1. Drejtori, në përfundim të hetimit, nëse ka dyshime të arsyeshme që eksperti ligjor ka kryer shkelje disiplinore, fillon procedimin disiplinor duke paraqitur pranë Komisionit Disiplinor përkatës raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.

2. Drejtori mbyll hetimin nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se:

- a) provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore;
- b) çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor, përveç rasteve kur paraqiten fakte ose prova të reja;
- c) çështja është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi për shkak të kalimit të afateve;
- ç) eksperti ka ndërruar jetë.

3. Përrjashtimisht, në rastet kur masa disiplinore jepet nga drejtori, ai merr vendim nëse është kryer shkelje dhe jep masën disiplinore përkatëse.

Neni 96

Hetimi për shkelje të tjera

Nëse gjatë procedimit disiplinor, drejtori merr informacion se ka dyshime të arsyeshme që mund të jetë kryer një shkelje tjetër, atëherë:

- a) i kërkon Komisionit Disiplinor të ndërpresë procedimin disiplinor, urdhëron shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, kryen hetimin e nevojshëm dhe paraqet raportin e hetimit të mëtejshëm brenda 1 muaji nga ndërprerja e procedimit; ose

b) i kërkon Komisionit Disiplinor që të shtojë ose ndryshojë objektin e procedimit disiplinor, nëse nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme.

Neni 97

Komisioni disiplinor

1. Komisioni disiplinor për ekspertët ligjorë është organ kolegjal, i cili përbëhet nga:
 - a) dy përfaqësues nga ministria;
 - b) dy përfaqësues nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë;
 - c) një përfaqësues nga institucionet publike të arsimit të lartë që ofrojnë programe studimi në fushën e mjekësisë ligjore.
2. Kryetari i komisionit disiplinor është një nga përfaqësuesit e zgjedhur nga ministri sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni. Kryetari dhe anëtarët e komisioneve disiplinore zgjidhen për një mandat 4 (katër) vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
3. Përfaqësuesit e institucioneve të përcaktuar në shkronjën “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
 - a) të jenë shtetas shqiptarë;
 - b) të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për mjekësi, ose diplomë të njësuar me të;
 - c) të kenë jo më pak se 10 vjet përvojë profesionale;
 - ç) të mos jenë shkarkuar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
 - d) të mos kenë qenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - dh) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit në kuptimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;
 - e) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, si dhe të afërm të shkallës së parë që është ekspert ligjor në detyrë.
4. Anëtarët e Komisionit Disiplinor duhet të jenë të pavarur e të paanshëm në vendimmarrjen e tyre.
5. Mbledhja e Komisionit Disiplinor është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimet e Komisionit Disiplinor miratohen me shumicën e të gjithë anëtarëve të komisionit. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, zbatohen për aq sa gjejnë zbatim dispozitat e ligjit për funksionimin e organeve kolegiale të administratës shtetërore dhe enteve publike.
6. Anëtarët e Komisionit Disiplinor duhet të tërhiqen ose të përjashtohen nga shqyrtimi i çështjeve, kur ata kanë konflikt interesi, apo ka dyshime në lidhje me paanësinë e tyre, në përputhje me nenin 30, 31 dhe 32 të Kodit të Procedurave Administrative.
7. Anëtarët e Komisionit lirohen dhe shkarkohen nga Komisioni për të njëjtat shkaqe për lirim dhe shkarkimin e tyre nga detyra në institucionin të cilin përfaqësojnë.
8. Komisioni Disiplinor mbështetet administrativisht nga ministria.
9. Rregulla të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimin të kushteve ligjore përcaktohen me urdhër të ministrit, me propozim të drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

10. Rregulla më të detajuara për procedurat për përzgjedhjen e përfaqësuesve dhe funksionimin e Komisioni Disiplinor, mënyrën e ushtrimit të përgjegjësive dhe zhvillimin e procedimit disiplinor përcaktohen me urdhër të ministrit.

11. Masa e shpërblimit të anëtarëve të komisioneve disiplinore caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave sipas rregullave të përcaktuara për shpërblimin e anëtarëve të organeve kolegjiale.

Neni 98

Procedura përpara Komisionit Disiplinor

1. Komisioni Disiplinor:

a) përcakton një datë për seancën dëgjimore, e cila duhet të jetë jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së dosjes; dhe

b) njofton palët për zhvillimin e seancës së paku 10 ditë përpara.

2. Afati i parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, mund të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë, nëse Komisioni Disiplinor është i bindur se ka arsye të rëndësishme për shtyrjen.

3. Komisioni Disiplinor duhet të marrë parasysh të gjitha rrethanat që kanë lidhje me çështjen.

4. Komisioni Disiplinor mund:

a) të marrë dëshmi shtesë, duke përfshirë thirrjen e dëshmitarëve; dhe

b) të angazhojë ekspertë të tjerë, kur e konsideron të përshtatshme.

5. Nëse provat shtesë nuk mund të sigurohen, Komisioni Disiplinor mund të kërkojë nga drejtori i Institutit të MjekësisëLigjoreqë të kryejë hetime të mëtejshme, duke specifikuar elementet e munguara dhe periudhën kohore për të cilën kërkohet hetimi.

6. Kërkesa e ekspertit ligjor për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me Institutin e Mjekësisë Ligjore nuk ndalon fillimin ose vazhdimin e procedimit disiplinor.

Neni 99

Mbyllja e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore

1. Komisioni Disiplinor vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore nëse:

a) shkelja disiplinore është parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi;

b) pas nisjes së procedimit, rezulton se çështja ka qenë objekt i një procedimi të mëparshëm;

c) eksperti ligjor ka ndërruar jetë.

3. Komisioni Disiplinor mbyll procedimin disiplinor, sipas parashikimeve të këtij neni, me vendim të arsyetuar me shkrim. Komisioni Disiplinor njofton palët për shkaqet e mbylljes së procedimit.

Neni 100

Bashkimi i procedimeve disiplinore, ndryshimi dhe shtimi i objektit të procedimit disiplinor

1. Komisioni Disiplinor, kur konstaton që procedimi disiplinor u referohet të njëjtave fakte dhe të njëjtit ekspert, mund të vendosë bashkimin e procedimeve.

2. Komisioni Disiplinor, kur e çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, pa marrë në shqyrtim një ose disa pretendime të tjera për shkëljen disiplinore ndaj të njëjtit ekspert, ka të drejtë:

a) të vendosë mbi pretendimet e ndryshuara ose të shtuara, nëse nuk është i nevojshëm hetimi i mëtejshëm, pasi të ketë dëgjuar palët në procedim; ose

b) pa pezulluar procedimin disiplinor, t'i kërkojë drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore të ndryshojë ose të shtojë objektin e procedimit disiplinor, në përputhje me këtë ligj, si dhe të hetojë këto pretendime të tjera të paktën brenda afatit njëmuor.

Neni 101

Të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë procedimit disiplinor

1. Gjatë procedimit disiplinor, eksperti ligjor ose përfaqësuesit të tij i sigurohet aksesit në dosje në masën që nuk cenon:

a) interesat ligjorë të palëve ose personave të tretë;

b) funksionet e organit vendimmarrës;

c) qëllimin e procedimit disiplinor.

2. Kur ekspertit i njoftohet se ndaj tij ka filluar procedim disiplinor, duhet që t'i bëhen të ditura të drejtat:

a) për të paraqitur një parashtrësë me shkrim në afatin e caktuar;

b) për të marrë pjesë në seancë dëgjimore;

c) për të thirrur dëshmitarë që mund të dëshmojnë fakte me interes për çështjen;

ç) për të paraqitur dokumente;

d) për të marrë masa të tjera për paraqitjen e provave në mbështetje të mbrojtjes së tij;

dh) për t'u përfaqësuar, sipas parashikimeve të Kodin të Procedurave Administrative.

3. Komisioni Disiplinor mund t'i kërkojë ekspertit ligjor të paraqesë të dhëna, dokumente ose çdo lloj prove, si dhe të marrë pjesë në seancë dëgjimore.

4. Palët kanë të drejtë të njoftohen për çdo vendim të Komisionit Disiplinor brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Neni 102

Seanca dëgjimore

1. Seanca dëgjimore për procedimet disiplinore është publike.

2. Komisioni Disiplinor, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura, në rastet kur:

a) publiciteti i seancës mund të dëmtojë moralin e shoqërisë ose mund të bëjë publike të dhëna sekrete që cenojnë sigurinë kombëtare, nëse kjo kërkohet nga autoritetet kompetente;

b) është e nevojshme të mbrohet e drejta e jetës private, sekretit tregtar, ose të dhënat personale të ekspertit ose një personi tjetër dhe në veçanti të personave të mitur;

c) kur nga publiku kryhen veprime që prishin zhvillimin normal të seancës dëgjimore.

3. Komisioni Disiplinor kur konsideron të nevojshme marrjen e provave shtesë, mund të shtyjë seancën për një periudhë jo më shumë se një muaj.

Neni 103
Pezullimi i procesit disiplinor

Rregullat për pezullimin e hetimit disiplinor, sipas nenit 90 të këtij ligji, zbatohen për atë sa është e mundur edhe për pezullimin e procedimit disiplinor.

Neni 104
Vendimmarrja e komisionit disiplinor për çështjet disiplinore

1 Komisioni disiplinor shqyrton rastin dhe merr vendim brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga data e paraqitjes së raportit të hetimit së bashku me dosjen hetimore pranë tij. Vendimi i arsyetuar i njoftohet ankuesit, nëse ka dhe ekspertit ligjor.

2. Pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe provave, komisioni disiplinor përkatës vendos:

a) rrëzimin e kërkesës për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore; ose

b) pranimin e kërkesës, marrjen e masave disiplinore dhe njoftimin e vendimit drejtorit të Institutit me qëllim nxjerrjen e urdhrit përkatës për zbatimin e masave që vendosen në procedimin disiplinor;

c) pranimin e kërkesës dhe njoftimin e vendimit drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore në rastet kur masat disiplinore vendosen nga drejtori.

Neni 105
Ekzekutimi i vendimeve

1. Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore merr të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e masave disiplinore dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të të gjitha masave që vendosen në përfundim të procedimit disiplinor.

2. Drejtori siguron zbatimin e masave disiplinore:

a) brenda një muaji, në rastin e gjobës;

b) brenda 2 (dy) javëve në të gjitha rastet tjera, sipas vendimmarrjes së Komisionit Disiplinor.

KREU XII

SHKELJET DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 106
Shkeljet disiplinore

1. Eksperti ligjor kryen një shkelje disiplinore në rastet kur:

a) vepron në kundërshtim me parashikimet ligjore, nënligjore apo metodat e punës;

b) kryen veprime që përbëjnë shkelje të rëndë të procedurave profesionale;

c) nuk përmbush me faj detyrat për kryerjen e ekspertimeve;

ç) kryen ekspertim në kushtet e konfliktit të interesit;

d) shkel detyrimet mbi respektimin e konfidencialitetit mbi të dhënat dhe informacionet që merr dijeni gjatë ushtrimit të profesionit si ekspert ligjor;

dh) ushtron praktika të ndaluara;

e) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e nje vepre penale gjatë ushtrimit të detyrës apo që lidhet me të;

f) kryen shkelje të përsëritur tërregullave të sjelljes dhe etikës.

2. Shkelje disiplinore janë edhe veprimet ose mosveprimet që përbëjnë vepër penale, pavarësisht faktit nëse dënimi penal është ekzekutuar, nëse ndjekja penale nuk është filluar ose nuk mund të vazhdojë, nëse eksperti është rehabilituar, faluar apo amnistuar, me kushtin që të mos kenë kaluar më shumë se 5 (pesë) vjet nga momenti i kryerjes së saj. Kjo pikë zbatohet vetëm nëse vepra penale cënon integritetin e profesionit të ekspertit.

Neni 107

Masat disiplinore

1. Masat disiplinore të zbatueshme në rastin e kryerjes së shkeljeve disiplinore janë si më poshtë:

a) paralajmërim me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim për gjobë apo shkarkim nga detyra;

c) gjobë në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

ç) pezullim nga detyra për një periudhë nga 3 (muaj) deri në 2 (dy) vjet;

d) shkarkim nga detyra.

2. Masa disiplinore jepet në proporcion me shkeljen dhe bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) shkallën e fajtit;

b) shpeshtësinë e kryerjes së shkeljes;

c) rrethanat e kryerjes së shkeljes, mundësinë dhe ardhjen e pasojave nga shkelja.

3. Gjopa mund të shoqërohet në mënyrë kumulative me masa të tjera disiplinore, të parashikuara nga shkronjat “a”, “b” dhe “ç” të pikës 3 të këtij neni.

4. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c” të pikës 3 të këtij neni jepen nga drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore

5. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “ç” e “d” të pikës 3 të këtij neni jepen vetëm me vendim të Komisionit Disiplinor.

6. Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda 5 (pesë) vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja.

Neni 108

E drejta e ankimit për masat disiplinore

1. Kundër vendimit për dhënien e masave disiplinore mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

2. Ankimi nuk pezullon zbatimin e tij, derisa vendimi gjyqësor mbi ankimin të marrë formë të prerë.

Neni 109

Regjistrimi dhe shuarja e masave disiplinore

1. Instituti i Mjekësisë Ligjore mban regjistrin e posaçëm për çështjet disiplinore të filluara ndaj ekspertëve ligjorë, si dhe vendimet e formës së prerë për këto procedime.
2. Këto masa shuhen dhe fshihen nga regjistri kur kanë kaluar afatet e mëposhtëme:
 - a) 1 (një) vit nga vendosja e masës disiplinore të paralajmërimit me shkrim;
 - b) 2 (dy) vjet nga vendosja e masës disiplinore të vërejtjes me shkrim;
 - c) 3 (tre) vjet nga data e ekzekutimit të masës disiplinore me gjobë;
 - ç) 5 (pesë) vjet nga data e ekzekutimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

KREU XIII

LABORATORËT DHE MORGU

Neni 110

Laboratori i toksikologjisë ligjore

1. Me qëllim kryerjen e ekspertimeve toksikologjiko-ligjore në Institutin e Mjekësisë Ligjore funksionon laborator i toksikologjisë.
2. Laboratori i toksikologjisë në Institutin e Mjekësisë Ligjore kryen ekspertime toksikologjiko-ligjore në:
 - a) mostrat biologjike të marra në organet e brendshme të kufomave të freskëta, të dekompozuar, të ekzumuara;
 - b) mostrat biologjike të marra të personat e gjallë;
 - c) mostrat e marrë nga provat materiale që dyshohet të kenë lidhje me helmime të ndryshme;
 - ç) mostrat biologjike të personave me helmime akute të shtruar në spitale, për përcaktimin e saktë të diagnozës së tyre.
3. Laboratori i toksikologjisë ligjore në Institutin e Mjekësisë Ligjore funksionon me Procedura Standarte të Punës të miratuara në udhëzuesin praktik
4. Procedurat standarde të punës parashikojnë procedurën e pranimit, grumbullimit dhe ambalazhimit të mostrave, kushtet dhe afatin e mbajtjes së tyre dhe procedura të tjera të detajuara mbi ekzaminimin toksikologjiko-ligjor.

Neni 111

Laboratori i biologjisë ligjore

1. Me qëllim kryerjen e ekspertimeve biologjike ligjore në Institutin e Mjekësisë Ligjore funksionon laborator i biologjisë.
2. Laboratori i biologjisë në Institutin e Mjekësisë Ligjore kryen ekspertime biologjiko-ligjore në mostra biologjike si: inde të buta, gjak, qime trupore, sekrecione biologjike apo eshtra, si dhe provave materiale në të cilat mund të gjenden mbetje biologjike.

3. Laboratori i biologjise ligjore në Institutin e Mjekësisë Ligjore funksionon me Procedura Standarte të Punës të miratuara në Udhëzuesin praktik.

4. Procedurat standarde të punës parashikojnë procedurën e pranimit, grumbullimit dhe ambalazhimit të mostrave, kushtet dhe afatin e mbajtjes së tyre si dhe procedura të tjera të detajuara mbi ekzaminimin biologjik-ligjor.

Neni 112

Laboratori i anatomisë patologjike ligjore

1. Me qëllim kryerjen e ekspertimeve anatomopatologo-ligjore në Institutin e Mjekësisë Ligjore funksionon laboratorin i anatomisë patologjike.

2. Laboratori i anatomisë patologjike në Institutin e Mjekësisë Ligjore kryen ekspertime anatomopatologjike ligjore në mostra biologjike si: pjesëza të gjithë indeve të trupit të kufomës.

3. Laboratori i anatomisë patologjike ligjore në Institutin e Mjekësisë Ligjore funksionon me Procedura Standarte të Punës të cilat përcaktohen në udhëzuesin praktik.

4. Procedurat Standarde të Punës parashikojnë procedurën e pranimit, grumbullimit dhe ambalazhimit të mostrave, kushtet dhe afatin e mbajtjes së tyre si dhe procedura të tjera të detajuara mbi ekzaminimin anatomopatologjik-ligjor.

Neni 113

Laboratori i antropologjisë ligjore

1. Me qëllim kryerjen e ekspertimeve antropologjiko -ligjore në Institutin e Mjekësisë Ligjore funksionon laboratorin i antropologjisë ligjore.

2. Laboratori i antropologjisë ligjore në Institutin e Mjekësisë Ligjore kryen ekspertime antropologjiko- ligjore në mbetjet mortore kockore.

3. Laboratori i antropologjisë ligjore në Institutin e Mjekësisë Ligjore funksionon me Procedura Standarde të Punës të cilat përcaktohen në udhëzuesin praktik.

4. Procedurat Standarde të Punës parashikojnë procedurën e pranimit, grumbullimit dhe ambalazhimit të mostrave, kushtet dhe afatin e mbajtjes së tyre si dhe procedura të tjera të detajuara mbi ekzaminimin antropologjik-ligjor.

Neni 114

Morgu

1. Morgu është strukturë e posaçme për kryerjen e autopsisë dhe për ruajtjen e kufomave deri në momentin e dorëzimit të kufomës.

2. Instituti i Mjekësisë Ligjore në nivel qendror është i pajisur me morg.

3. Për realizimin e detyrave në nivel vendor, Instituti administron morgun e institucionit spitalor publik sipas strukturës së miratuar me urdhër të Kryeministrit. Instituti i Mjekësisë Ligjore bashkëpunon me spitalet publike për realizimin e veprimtarisë në morg.

4. Organi procedues mund të urdhërojë kryerjen e autopsisë vetëm në ambientet përkatëse të Institutit të Mjekësisë Ligjore, në raste të veçanta kur kërkohen ekzaminime të caktuara që nuk ofrohen në nivel vendor me qëllim sigurimin e kushteve të përshtatshme për një procedurë të tillë.

Neni 115

Tarifat e shpenzimeve të morgut të Institutit

1. Shpenzimet e ruajtjes së kufomave apo pjesëve të tyre dhe eshtrave në morgun e Institutit të Mjekësisë Ligjore, si dhe çdo shërbim shtesë, i ngarkohen organit me kërkesën e të cilit është kryer ekzaminimi ose familjarëve në rast se ekzaminimi është realizuar me kërkesën e tyre.

2. Tarifat për shpenzimet sipas pikës 1 të këtij neni miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për financat.

KREU XIV

PRAKTIKAT MËSIMORE DHE PROFESIONALE

Neni 116

Organizimi i procesit mësimor

1. Institutit i Mjekësisë Ligjore është përgjegjës për organizimin, menaxhimin dhe ofrimin e praktikave mësimore/profesionale për studentët në fushën e mjekësisë dhe specializantët në fushën e mjekësisë ligjore.

2. Institutit i Mjekësisë Ligjore disponon të gjithë infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e praktikave mësimore/profesionale studentëve dhe specializantëve në morg, laboratorët toksikologjikë, histopatologjikë dhe biologjikë.

3. Institutit mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë në fushën e mjekësisë për organizimin e praktikave mësimore/profesionale lidhur me numrin, të dhënat dhe orët e zhvillimit të tyre për studentët që ndjekin studimet apo specializimin në fushën e mjekësisë ligjore.

4. Rregulla më të detajuara për mbarëvajtjen e praktikave mësimore/profesionale përcaktohen me udhëzim të drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

KREUXV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 117

Dispozitë kalimtare

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nëpunësit aktualë të Institutit të Mjekësisë Ligjore, që gëzojnë statusin e nëpunësit civil, si dhe të gjithë punonjësit ndihmës dhe administrativë vijojnë të ruajnë pozicionet e tyre të punës në Institutin e Mjekësisë Ligjore.

2. Aktet nënligjore që rregullojnë fushën e veprimtarisë së Institutit të Mjekësisë Ligjorembeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, për aq sa nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji.

Neni 118
Akte nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave, ministri, ministri përgjegjës për financat dhe drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore që brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”

KRYETAR
LINDITA NIKOLLA